



AKTUALE

**SHQIPËRIA DHE MALI I ZI
PAJTOHEN PËR AVANCIMIN E
BASHKËPUNIMIT EKONOMIK**

F. 2

**SBASHK-U, BYTYQIT:
KUJDES ME MËSIMDHËNËSIT
E ARSIMIT TË MESËM TË
LARTË**

F. 6

**HOXHA: PROCESI
I INTEGRIMIT ËSHTË
KOMPLEKS DHE KËRKON
SHUMË REFORMA**

F. 6

EKONOMI

**ANP 'ADEM JASHARI'
SHPALLET FITUES I ÇMIMIT
PËR BIZNES TË
PËRGJEGJSHËM**

F. 9

**DOGANA E KOSOVËS PËR
GJASHTË MUAJ MBLODHI
504.3 MILIONË EURO**

F. 9

KULTURË

**'DEKADA' NGA JETON
KRASNIQI SJELL DASHURINË
PËR REP MUZIKËN**

F. 10

SPORT

**MKRS-ja, 250 MIJË EURO
PËR FUTBOLLIN**

F. 15

**ELIMINOHET ZVICRA E
SHQIPTARËVE**

F. 16



FLET PËR "EPOKËN E RE", NAIM RASHITI | FAQE 4-5

Besoj se partitë do të arrijnë konsensus për fazën finale të dialogut

Drejtori ekzekutiv i Grupit për Hulumtim të Politikave në Ballkan, Naim Rashiti, është shprehur i bindur se Kosova do të arrijë një konsensus nacional për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se konsensusi do të jetë që Kuvendi i Kosovës do ta miratojë platformën për bisedime dhe ekipin negociator, të cilit do t'i prijë presidenti Hashim Thaçi. Rashiti ka bërë me dije se në këtë proces Kosova duhet të jetë kreative në pozicionet e saj karshi kërkesave të Serbisë. Sipas tij, Kosova në këtë proces të dialogut me Serbinë nuk duhet të marrë pozicion defensiv, sepse në këto negociata nuk po shkon për ta negociuar pavarësinë e vet.

UNDP-ja: Qytetarët të kënaqur me punën e presidentit

Papunësia, korrupsioni dhe varfëria janë tri çështjet kryesore me të cilat ballafaqohet edhe më tutje shteti i Kosovës. Ky është perceptimi i qytetarëve të

anketuar sipas të dhënave të raportit "Pulsi Publik XIV" të realizuar nga UNDP-ja. Po sipas të gjeturave të këtij raporti, presidenti gëzon nivelin më të

lartë të kënaqshmërisë së qytetarëve me 39.1 për qind, i pasuar nga kryeministri me 33.2 për qind dhe kryeparlamentari me 31.5 për qind | FAQE 3



PSD-ja kërkon që Kuvendi i Kosovës ta mbikëqyrë dialogun

Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate, Visar Ymeri, ka thënë se është e domosdoshme që Kuvendi i Kosovës do të jetë i përfshirë në procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se

legjitimiteti në këtë proces fitohet vetëm nëse Kuvendi është i përfshirë përgjatë gjithë dialogut. "Platforma duhet të miratohet në Kuvendin e Kosovës", ka thënë Ymeri | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Pritren-Kosovë
Product of EPS and XPS
Mob.: +377(0) 44 506 815
Tel&Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Në Shkodër mbahet mbledhja e përbashkët Shqipëri - Mali i Zi

Shqipëria dhe Mali i Zi pajtohen për avancimin e bashkëpunimit ekonomik

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ai i Malit të Zi, Dushko Marković, përmes mbledhjes së përbashkët qeveritare ndërmjet dy vendeve kanë theksuar se marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Malit të Zi janë të mira dhe se ato duhet të thellohen përmes bashkëpunimit edhe më të fuqishëm ekonomik

"Epoka e re"

SHKODËR, 3 KORRIK - Të martën në Shkodër është mbajtur mbledhja e përbashkët e dy qeverive, Shqipëri - Mali i Zi. Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ai i Malit të Zi, Dushko Marković, theksuan se marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Malit të Zi janë të mira dhe se ato duhet të thellohen përmes bashkëpunimit edhe më të fuqishëm ekonomik. Në fjalën e tij, kryeministri Edi Rama ka deklaruar se Shqipëria dhe Mali i Zi sot janë "më të ndërlidhur se kurrë më parë" por, sipas tij, në këtë ndërlidhje ka potenciale të mëdha të pashfrytëzuara. "Kemi një dialog si s'ka më të mirë politik. Na vjen mirë që na u dha mundësia ta shprehim me veprim të gjithë dashurinë dhe respektin për ju duke mbështetur pa rezervë anëtarësimin e Malit të Zi në NATO. Edhe sot më skeptikët mund ta shohin se

anëtarësimi i Malit të Zi në NATO ka kontribuar më së miri. Hapja e pikave të reja kalimtare që janë jo vetëm një sukses i këtij takimi, por edhe një bazë më të gjerë për vlera ekonomike dhe turistike", ka thënë Rama. Ai ka thënë se turizmi i Malit të Zi është një shembull për t'u ndjekur. "Së fundi, duke ndjekur edhe shembullin tuaj të turizmit, që është një shembull i shkëlqyer dhe duke komunikuar edhe me investitorët që janë të pranishëm në bregdetin tuaj, e kemi dëgjuar nevojën tuaj për t'u zgjeruar me investime edhe në anën tonë të kufirit. Kemi gjetur gjuhën pa asnjë mundim për t'i inkurajuar shkëmbimet kulturore. Kemi shumë për të bërë kur vjen puna tek nxitja e shkëmbimeve tregtare, pasi sot nuk janë në nivelin e duhur duke pasur parasysh potencialin që kemi. Duhet t'i heqim barrierat tarifore që shpeshherë bëhen problem për importuesit tanë në të dyja anët. Më vjen



shumë mirë që kjo mbledhje qeverie pasohet nga një forum i biznesit", ka thënë kryeministri Rama.

Ai ka bërë me dije se me Malin e Zi nënshkruan disa marrëveshje, ku mes tyre ishte edhe hapja e pikës kufitare në Zogaj. "Do të bëjmë lehtësim të shkëmbimeve tregtare me reduktim të tarifave. Sot kemi nënshkruar marrëveshjen për pikën e përbashkët kufitare në Zogaj. Kjo pikë e shumëkërkuar prej vitësh do të

jetë një burim më shumë i ndërveprimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të turizmit. Do ta analizojmë edhe hapjen e një pike tjetër kufitare. Unë jam shumë besimplotë që me Malin e Zi do të bëjmë progres të shpejtë dhe të qëndrueshëm", është shprehur Rama.

Edhe kryeministri i Malit të Zi, Dushko Marković, ka thënë se duhet avancuar në bashkëpunimin ekonomik në mes të Shqipërisë dhe Malit të

Zi. Të dy kryeministrat kanë folur edhe për çështjen e migrantëve që lëvizin përgjatë rrugës që përfshin dy vendet. "Në rast të valës së migrantëve, jemi të gatshëm ta pranojmë barrën dhe përgjegjësitë brenda projektit evropian për shpërndarjen e barrës. Nuk do të bëhemi vend i rrethojave dhe mureve, por as shpëtimtarë të vendeve të pasura që i trajtojnë migrantët si mbetje toksike", ka thënë Rama.

Shkon në Kuvend Projektligji për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme



PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, ka mbajtur të martën mbledhjen e radhës, kryesuar nga Albulena Haxhiu, kryetare, në të cilën ka shqyrtuar Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Anëtarët e komisionit diskutuan

për përmbajtjen e Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme lidhur me privatizimin, mandatin e EULEX-it, çështjet e Gjykatës së Apelit, sistemit të drejtësisë, si dhe lëndët e pazgjidhura nga gjykatat.

Komisioni përkrahu në parim Projektligjin për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Mbledhja ka vazhduar me shqyr-

timin e Projektligjit për plotësimin e Ligjit për familjen, i cili hyri në rend dite dhe u përkrah në parim.

Kërkesa për inicimin e procedurave për ndryshim-plotësimin e Ligjit për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta banesore iu procedua Komisionit për Bujqësi, ndërsa kërkesa e Sindikatës së pavarur të ish-Këshillit Komunal për Financim Gjakovë, vitet 1992-1999, iu dërgua Komisionit për Shëndetësi.

Ukraina nuk e njeh Kosovën, "respekton interesat e Serbisë"

BEOGRAD, 3 KORRIK - Serbia e ka respektuar dhe do ta respektojë integritetin territorial të Ukrainës. Kështu ka thënë të martën presidenti i Serbisë, Aleksandar Vučić, në një konfer-

encë të përbashkët për media me homologun ukrainas Petro Poroshenko në Beograd. Vučić e falënderoi Ukrainën për, siç tha, respektimin e integritetit territorial të Serbisë. "Shpresojmë dhe

duam që të gjitha problemet në Ukrainë të zgjidhen në mënyrë të qetë", ka thënë Vučić.

Poroshenko ka thënë se Ukraina nuk e ka njohur Kosovën dhe se problemi i saj duhet të zgjidhet

duke respektuar interesat e Serbisë. "Mund të konfirmoj se Ukraina dhe Serbia nuk kanë asnjë problem në marrëdhëniet dypalëshe", ka deklaruar Poroshenko.



Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) ka publikuar raportin "Pulsi Publik XIV"

UNDP-ja: Qytetarët të kënaqur me punën e presidentit



Papunësia, korrupsioni dhe varfëria janë tri çështjet kryesore me të cilat ballafaqohet edhe më tutje shteti i Kosovës. Ky është perceptimi i qytetarëve të anketuar sipas të dhënave të raportit "Pulsi Publik XIV" të realizuar nga UNDP-ja. Po sipas të gjeturave të këtij raporti, presidenti gëzon nivelin më të lartë të kënaqshmërisë së qytetarëve me 39.1 për qind, i pasuar nga kryeministri me 33.2 për qind dhe kryeparlamentari me 31.5 për qind

të kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e shumicës së institucioneve ekzekutive, legislative dhe gjyqësore të Kosovës. "32.5 për qind e qytetarëve kanë deklaruar se janë të kënaqur me institucionet kryesore të Kosovës. 33.2 për qind e qytetarëve të anketuar janë shprehur të kënaqur me punën e kryeministrit. 32.9 për qind e qytetarëve janë të kënaqur me punën e Kuvendit, ndërsa 31.5 për qind janë të kënaqur me punën e kryetarit të Kuvendit", ka theksuar ai. Por, për dallim nga kryeministri dhe kryeparlamentari, presidenti gëzon nivelin më të lartë të kënaqshmërisë së qytetarëve. "Presidenti gëzon nivelin më të lartë të kënaqshmërisë mes qytetarëve, pasi anketa aktuale tregon se 39.1 për qind e kosovarëve janë të kënaqur me punën e presidentit", është shprehur Hetemi.

Ai ka bërë me dije se, sipas të gjeturave të raportit, është ulur niveli i kënaqshmërisë së

qytetarëve me punën e gjyqësorit. "31.2 e qytetarëve janë shprehur të kënaqur me punën e gjykatave, kurse 29.9 janë deklaruar të kënaqur me punën e Prokurorisë. Duhet të theksohet se nivelet e kënaqshmërisë me Prokurorinë dhe institucionet qendrore janë më të ulëta kur krahasohen me të gjitha institucionet e tjera. Kjo sugjeron se humbja e besimit në sundimin e ligjit dhe qeverisjen ka ndikuar në nivelet e përgjithshme të kënaqshmërisë me të gjitha institucionet e tjera", ka theksuar Hetemi. Sipas tij, rënia e kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e institucioneve kyçe ka reflektuar edhe në perceptimet e të anketuarve për drejtimin aktual politik të Kosovës. "Rreth 15 për qind e qytetarëve janë shprehur të kënaqur ose shumë të kënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës. Gjysma e të anketuarve, 50.5 për qind, raportojnë se janë të pakënaqur

ose shumë të pakënaqur me drejtimin aktual politik të Kosovës, ndërsa 34 për qind janë deklaruar si neutralë (as të kënaqur dhe as të pakënaqur). Kurse rreth 38 për qind e qytetarëve kanë shprehur gatishmëri për t'u bërë pjesë e protestave për arsye politike", ka deklaruar Hetemi. Më tutje, ai ka treguar se "Pulsi Publik XIV" ka prezantuar perceptimet e qytetarëve edhe sa i përket sigurisë së vend. "Të dhënat tregojnë se 67 për qind e qytetarëve të anketuar ndihen të sigurt, kurse rreth 33 për qind ndihen përgjithësisht të pasigurt. Të dhënat e zërthyer sipas gjinisë nuk tregojnë dallime të konsiderueshme në opinionet e burrave dhe grave në lidhje me sigurinë dhe sigurimin kur janë në rrugë", është shprehur Hetemi.

Raportin "Pulsi Publik XIV" përfshin periudhën mes tetorit të vitit 2017 dhe prillit të vitit 2018.

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 3 KORRIK - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) të martën ka publikuar raportin "Pulsi Publik XIV", i cili prezanton perceptimet e qytetarëve për punën e institucioneve qendrore të Republikës së Kosovës. Në një konferencë për medie, menaxheri i projektit "Pulsi Publik XIV", Atthe Hetemi, ka bërë me dije se, sipas të dhënave të këtij raporti, shumica e qytetarëve të anketuar kanë vlerësuar se papunësia,

korrupsioni dhe varfëria janë tri problemet kryesore me të cilat ballafaqohet Kosova. "29 për qind e qytetarëve të anketuar e mendojnë papunësinë si çështjen kryesore, 14 për qind korrupsionin dhe 8 për qind varfërinë. Kurse 6 për qind e të anketuarve e konsiderojnë arsimin si çështje themelore, ndërsa rreth 5 për qind e konsiderojnë krimin e organizuar dhe shërbimet shëndetësore si shqetësimet e tyre më të ngutshme në Kosovë", ka treguar Hetemi.

Ai ka thënë se "Pulsi Publik XIV" tregon një rënie të përgjithshme

Projektligji për Komplexin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz procedohet për në Kuvend

PRISHTINË, 3 KORRIK - Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, në mbledhjen e së martës, të udhëhequr nga Daut Haradinaj, ka shqyrtuar

Projektligjin për Komplexin "Adem Jashari" në Prekaz. Projektligji me amendamentet e propozuara u procedua për shqyrtim të mëtejshme në Kuvendin e Kosovës.

"Edhe zyrtarisht Komplexi i Jasharëve me ligj të posaçëm", ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook" kryetari i këtij komisioni, Daut Haradinaj.



Flet për "Epokën e re", Naim Rashiti

Besoj se partitë do të arrijnë kons

Drejtori ekzekutiv i Grupit për Hulumtim të Politikave në Ballkan, Naim Rashiti, është shprehur i bindur se Kosova do të arrijë një konsensus nacional për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka treguar se konsensusi do të jetë që Kuvendi i Kosovës do ta miratojë platformën për bisedime dhe ekipin negociator, të cilit do t'i prijë presidenti Hashim Thaçi. Rashiti ka bërë me dije se në këtë proces Kosova duhet të jetë kreative në pozicionet e saj karshi kërkesave të Serbisë. Sipas tij, Kosova në këtë proces të dialogut me Serbinë nuk duhet të marrë pozicion defensiv, sepse në këto negociata nuk po shkon për ta negociuar pavarësinë e saj

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 KORRIK -

"Epoka e re": Z. Rashiti, subjektet politike deri më tani kanë mbajtur disa tryeza politike për të arritur një konsensus nacional për temat e mëdha, por deri më tani nuk ka ndonjë rezultat. Cili është vlerësimi juaj për këtë iniciativë?

Rashiti: Pas një periudhe të tensioneve të mëdha mes subjekteve politike dhe moskomunikimit, tani jemi në një periudhë ku partitë politike lirshëm komunikojnë me njëra-tjetrën dhe ulen e bashkëbisedojnë për të gjitha temat. E mira e këtyre muajve të fundit është se flitet për tema të mëdha ndaras prej proceseve të brendshme. Tani është kuptuar që temat e mëdha më nuk zgjidhen nga Qeveria. Besoj se tryezat e organizuar nga vetë partitë politike, nga shoqëria civile dhe nga ne që i kemi organizuar më herët mes subjekteve politike dhe nënkryetarëve të partive kanë çuar drejt një procesi i cili përcakton strukturën apo funksionimin e një ekipi negociator me mandat nga Kuvendi për ta përmbyllur nëse është e mundur dialogun me Serbinë. Besoj se kjo do të ndodhë në javët dhe muajt në vijim. Në fazat e mëvonshme besoj se do të ketë nevojë për një konsensus ose bashkërendim edhe në disa tema të tjera. Përveç formimit të ushtrisë do të kërkohet konsensus edhe në reformat e thella që do të duhet të bëhen në lidhje me proceset integruese.

"Epoka e re": Si më urgjente po shihet arritja e një konsensusi nacional për fazën finale të dialogut me Serbinë. Meqenëse ju edhe më herët keni ndërmjetësuar mes subjekteve politike dhe i njihini nga afër ato, besoni se kanë vullnet politik partitë të arrijnë një konsensus për këtë çështje?

Rashiti: Është vështirë të mendohet që subjektet politike parlamentare të mbesim jashtë procesit politik në lidhje me dialogun me Serbinë. Po ashtu, është vështirë edhe dikush të mendojë se pa një masë kritike

të Kuvendit të Kosovës të bëjë një proces të dialogut me Serbinë, i cili për mua do të jetë shumë kompleks dhe shumë i vështirë. Mendoj se të gjitha subjektet politike e kuptojnë rëndësinë e pjesëmarrjes dhe rëndësinë e procesit të dialogut me Serbinë. Jam i bindur se shumica apo të gjitha partitë do të jenë pjesë e këtij procesi në një mënyrë apo në një tjetër. Nëse të gjitha subjektet politike nuk do të jenë në ekipin negociator, atëherë ato do të jenë pjesë e mekanizmave të tjerë, qoftë në komisione apo grupe parlamentare për mbikëqyrjen dhe ruajtjen e konsensusit që do të funksionojnë në Kuvend. Po ashtu, ka një konsensus që për këtë proces të shkojë përmes Kuvendit. Besoj se subjektet parlamentare do të veprojnë në atë mënyrë që Kuvendit të Kosovës t'ia japin një fuqi të caktuar për të krijuar ekipin negociator që ta udhëheqë dialogun me Serbinë.

"Epoka e re": Në publik duket se palët janë shumë larg arritjes së këtij konsensusi. Presidenti Thaçi disa herë ka ftuar opozitën të jetë pjesë e këtij procesi derisa opozita dhe një parti nga koalicioni qeverisës e kanë refuzuar këtë ftesë.

Rashiti: Nuk besoj se janë dallimet me apo pa opozitë, apo kush do të jetë bartës i procesit të dialogut. Dallimet janë se si të krijohet struktura e procesit të dialogut nga ana e Kosovës dhe parimet e këtij procesi. Pra, se si do të shkojë rrjedha e përgatitjes së këtij procesi tutje. Besoj se partitë politike mund të arrijnë konsensus që emërimi i ekipit negociator dhe platforma të ecin në mënyrë paralele. Tani për tani kemi një lloj debati për rolin e presidentit dhe opozitës. Duhet ta shohim një qasje më proaktive të Qeverisë në këtë proces, në veçanti të PDK-së si partia më e madhe në pushtet dhe të subjekteve të tjera se si ta formësojmë ekipin negociator. Me këtë ekip negociator që do ta emërojë Kuvendi i Kosovës presidenti atëherë do të punojë. Ka ide të ndryshme se si do të duket ky ekip apo çfarë niveli të përfaqësimit do të ketë. Unë

dysjoj se subjektet politike ende nuk janë duke e kuptuar kompleksitetin e këtij procesi. Në këtë proces do të ketë nevojë për shumë procese për faktin se do të jetë kompleks. Nëse e lexoni mirë marrëveshjen Greçi - Maqedoni, shihen se sa çështje janë shtjelluar në një traktat paqeje. Besoj se edhe traktati i paqes Kosovë - Serbi në fund do t'i elaburojë në detaje të gjitha pikat e rregullimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve. Dhe këtu Kosovës do t'i duhet ekspertiza për çështje në anëtarësim në organizata ndërkombëtare, për traktatet ndërkombëtare, për çështje integruese evropiane, kushtetutshmëri etj. Pra, do të duhej një grup i madh i njerëzve të punojnë në këtë proces. Sa më shumë që vonohemi do të bëhet më vështirë për ta kompletuar gjithë strukturën e këtij mekanizmi negociator. Takimet mes palëve nuk janë vetëm ato që shihen në televizione, në nivel presidentësh. Mendoj se në një fazë do të ketë takime disaditore mes Kosovës dhe Serbisë. Pastaj në momentin e përpilimit të marrëveshjes përfundimtare do të ketë shumë punë. Konsensusi do të jetë në dy nivele. Së pari në nivelin institucional, që përfshinë konsultat me liderët politikë dhe rolin e subjekteve parlamentare, qoftë përmes pjesëmarrjes direkte në ekip negociator, qoftë përmes mbështetjes, monitorimit apo këshillimit nga Kuvendi. Së dyti, Qeveria mund të marrë një rol të madh në procesin negociator duke deleguar një përfaqësues për ta koordinuar gjithë ekipin negociator, bartës i të cilit besoj se do të jetë presidenti.

"Epoka e re": Ju parashikoni se ekipin negociator, së bashku me platformën për dialog, do ta miratojë Kuvendi, kurse delegacionin do ta udhëheqë presidenti Thaçi?

Rashiti: Besoj se kështu diçka do të jetë. Varësisht formulës apo nivelit të përfaqësimit në ekip negociator, se a do të jenë liderët apo nënkryetarët e partive. Megjithatë, kështu diçka do të jetë.

"Epoka e re": Në bazë të kësaj, ju jeni të bindur se më në fund do të ketë konsensus kombëtar për këtë fazë të dialogut?

Rashiti: Nuk besoj se do të mund të shkojmë larg në dialog pa një konsensus apo bashkërendim të shumicës së partive parlamentare.

"Epoka e re": Parashikimet janë se kjo fazë e procesit nuk do të jetë e lehtë për Kosovën. Nga këndvështrimi juaj, sa sfiduese do të jetë kjo për Kosovën?

Rashiti: Konkluzat e Këshillit të BE-së kësaj here e bënë të qartë se Serbia nuk mund të avancojë pa një marrëveshje me Kosovën. Kështu që, Serbia pret që në qershor të vitit 2019 të marrë dritën jeshile për ta vazhduar procesin. Pas zgjedhjeve në BE, Kuvendi dhe komisioni i BE-së do të kenë strukturë tjetër. Pra, ky është afati minimal për Serbinë. Ndërsa Kosovës i kërkohet të jetë gati ta finalizojë një marrëveshje me Serbinë, e cila në rastin ideal do të arrihej në dhjetor apo në fillim të vitit të ardhshëm, kurse në rastin më të largët pretendohet të arrihet deri në qershor të vitit të ardhshëm. Duhet të sqarohet se ky proces nuk është për ta rinegociuar pavarësinë apo kufijtë shtetërorë të Kosovës, por është proces për t'i rregulluar marrëdhëniet Kosovë - Serbi dhe për t'i rregulluar të drejtat e anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare për të dyja vendet, për Serbinë në BE, kurse për Kosovën së paku në OKB e BE, ndërsa NATO-ja besoj se do të vijë vetvetiu. Pritjet e Serbisë dhe Kosovës në këtë proces janë ende larg njëra-tjetrës. Nuk është procesi i përafuar siç ishte ai në mes të Greqisë dhe Maqedonisë. Mendoj se në këtë proces do të ketë surpriza të mëdha nga Serbia, me kërkesa të ndryshme, qoftë për rregullim e brendshëm, qoftë për çështjen e kufijve apo për gjëra të tjera. Mendoj se qëndrimet e subjekteve politike nuk janë larg se çka duan nga ky proces, por ende nuk janë të formësuar. Ajo që duhet të bëjë Kosova tash është që përmes një konsensusi të brendshëm të

krijohet vigjilenca në proces se çfarë mund të përfitohet nga ky proces, e çka jo.

Qëllimi dihet. E drejta e anëtarësimit të Kosovës në OKB përmes një traktati me Serbinë. Kjo tani kërkohet edhe nga miqtë ndërkombëtarë të Kosovës, pastaj është çështje tjetër se si do të implemetohet kjo për shkak të Rusisë. Kosova nuk duhet të frikësohet nga ky proces. Në fakt, Kosova në këtë proces duhet të bëhet kreative, të gjej ide dhe mënyra se si të arrihet deri të qëllimi i këtij procesi. Megjithatë kryesorja është krijimi i një mekanizmi konsistent të konsensusit. Pra, një mekanizëm konsistent, ku konsultat janë të përhershme, sepse dialogu do të ketë

ensus për fazën finale të dialogut



Asociacioni, dështim i pjeshëm i Kosovës

"Epoka e re": *Moszbatimi i marrëveshjes së Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe do ta vështirësojë marrëveshjen finale?*

Rashiti: Palët kanë nënshkruar marrëveshjen në vitin 2013 dhe janë të obliguar të punojnë në zbatimin e saj. Unë e shoh të pamundur zbatimin e marrëveshjes në pikun e negociatave më të vështira të mundshme. Politikisht Kosova po dëshiron që asociacionin ta shesë si pjesë të marrëveshjes finale, ndërsa Serbia nuk dëshiron zbatimin e kësaj marrëveshje, sepse për marrëveshjen finale shpreson një asociacion krejt tjetër. Ky është ndoshta një dështim i pjeshëm i Kosovës që ka lejuar që asociacioni të mbetet pjesë e negociatave finale, por edhe i BE-së që ka lejuar të mos ndodhë zbatimi i marrëveshjes. Po të kishim zbatim të plotë të marrëveshjeve të deritashme, pozicioni i Serbisë në këto negociata do të ishte më i dobët. Çështjet e moszbatimit të marrëveshjeve do të jenë pjesë e marrëveshjes gjithëpërfshirëse, të cilat do ta vështirësojnë atë. Këtu do të përfshihen ndoshta edhe rinegociimi i marrëveshjes që janë bërë deri më tani. Gjithashtu, do të ketë edhe insistime për këtë çështje. Për shembull, me rastin e kërkesave për status special të serbëve në veri, apo autonomi, do të përfshihen energjëtika dhe telekomi si pjesë të marrëveshjes. Këtu është ajo nevoja e kreativitetit të Kosovës që duhet të kemi përgjigje për çdo gjë. Në këtë drejtim duhet të kemi një llokim buxhetor dhe politik të institucioneve që të kërkohet edhe mbështetje ndërkombëtare për këtë proces. Ne duhet të llojmë tek shtetet anëtare të BE-së edhe për dialog me Serbinë, jo vetëm për liberalizim të vizave.

për nivelin e autonomisë apo statusin special për serbët në veri. Pra, kam frikë se Kosova po ngujohet në defansivë, derisa nuk besoj se ka arsye të jetë në defansivë.

surpriza dhe vështirësi të mëdha. Ne nuk mund të krijojmë kriza sa herë që ka vështirësi në dialog. Ne duhet të krijojmë mekanizma që i japin zgjidhje dhe lehtësojnë dialogun sa herë që ka kriza në dialog. Prandaj në këtë proces duhet të kërkohet zgjidhje që kënaqin Kosovën, sepse trakti kërkon marrëveshje të dyanshme, e cila do të jetë e pranueshme për të dyja palët. Kjo do të jetë vështirësia më e madhe. Historikisht shqiptarët dhe serbët nuk kanë pasur marrëveshje të pranueshme prej dy palëve. Sikurse procesi edhe marrëveshjet përfundimtare do të jenë goxha të komplikuar, sikurse ndodhi edhe në rastin Greqi - Maqedoni.

"Epoka e re": *Sërish do të ketë kompromise në këtë proces, që do të shkojnë përtej pakos së Ahtisarit?*

Rashiti: Nuk shqetësohem për kompromise të ndryshme, sepse jeta politike dhe marrëdhëniet ndërkombëtare evulojnë. Kështu do të ndodhë edhe në të ardhmen. Unë shqetësohem nga mungesa e kreativitetit të Kosovës në këtë proces, e cila do ta vendoste Kosovën në pozicion defansiv. Kosova nuk është në këto negociata për ta humbur pavarësinë. Kështu që, në këtë proces Kosova duhet të jetë kreative me opsionet për zgjidhjen finale të raporteve me Serbinë. Nga Serbia mund të ketë kërkesa për autonomi të serbëve, për status special, për ndarje, si dhe

do të ketë kërkesa edhe për sovranitet pa ulëse në OKB. Pra, Kosova duhet të dalë në këtë proces me propozime për pozicionet e veta, të cilat do të jenë përgjigje ndaj ofertave të Serbisë. Nuk mund të thuash në proces vetëm jo, por duhet të ofrosh diçka kreative, me çka Kosova duhet t'i bindë miqtë ndërkombëtarë. Kompromisi është se si do të duket paketa përfundimtare dhe jo se cila palë po bën kompromis. Gjatë këtyre viteve të dialogut në Bruksel, procesi ka pasur kritika, për faktin se është folur vetëm për serbët në Kosovë dhe asgjë nuk është folur për definimin e raporteve shtetërore në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ndërsa tash dialogu do të jetë për definimin e raporteve Kosovë - Serbi.

"Epoka e re": *Si mund të jetë kreative Kosova në këtë proces?*

Rashiti: Ka disa mënyra që Kosova mund të jetë kreative. Për shembull, pakoja e Ahtisarit ka bërë një balancë të drejtave të serbëve në nivel lokal dhe atë qendror. Meqenëse kanë garanci të fuqishme në nivel qendror, duke përfshirë vendet e rezervuara dhe veton në parlament, atëherë është vështirë të flitet në këtë kontekst për autonomi më të madhe në nivel lokal. Këto dy çështje në një nivel të caktuar mund të negociohen. Nëse ka kërkesa prej Serbisë që të rinegociohet njëra prej këtyre çështjeve, atëherë do të prishej balanca. Pastaj duhet t'u përgjigjemi me argumente kërkesave jolegjitime

LB-ja kritikon pozitën dhe opozitën për qasjen ndaj dialogut me Serbinë

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Lëvizja për Bashkim (LB), e cila drejtohet nga Valon Murati, ka vlerësuar se partitë politike në Kosovë janë në defensiva sa i përket procesit dialogut me Serbinë. "Në shtetin tonë mungon mentaliteti shtetëror. Një prej problemeve të mëdha sa iu përket bisedimeve Kosovë - Serbi është qasja totalisht defensiva e subjekteve politike, pozitë e opozitë, në Kuvendin e Kosovës, ndaj bisedimeve e ndaj Serbisë. Kjo qasje reflektohet në shprehjet si: pasoja nga bisedimet, kushte për Serbinë, kompromise të domosdoshme, vija të kuqe ndaj Serbisë etj. Pra, krejt energjia e tyre orientohet në atë se si të mbrohemi prej Serbisë. Mentaliteti ynë nuk guxon të jetë mentaliteti i tillë disfatist. Mentaliteti ynë duhet të jetë mentaliteti fitimtar", është thënë në reagimin e LB-së. Sipas LB-së, energjia e Kosovës do të duhej të orientohej në atë

se si të fitojmë në raport me Serbinë, e jo si të mbrohemi prej saj. "Lëvizja për Bashkim me kohë e ka përjashtuar këtë qasje ndaj problemit shqiptaro-serb. Duke qenë se Serbia është në proces të integrimi evropiane dhe ky proces është i lidhur me normalizimin e raporteve me Kosovën, me pak kreativitet ne kemi mundur e mundemi që situatën ta kthejmë në favorin tonë. Ne që në fillim është dashur të pozicionohemi më mirë, duke u sjellë si shtet. Në vend se të flasim vetëm për temën e serbëve në Kosovë, për të cilën interesohet Serbia, do të duhej të insistonim që të flisnim edhe për temën e shqiptarëve në Kosovën Lindore si interes i Kosovës, si shtet. Atëherë do të krijonim balancë në tema dhe problemet do të zgjidheshin duke u bazuar në parimin e reciprocitetit", është thënë në reagimin e LB-së.



Ministri Ismaili viziton vendin ku do të vendoset aparati për angiografi

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar të martën hapësirën ku do të vendoset aparati për angiografi, i cili mundëson ofrimin e shërbimeve për sëmundje të zemrës dhe të enëve të gjakut. Ai ka bërë me dije për vite me radhë

se ky projekt kishte ngecur dhe pajisja e blerë ende nuk ka ardhur në Kosovë. Me zgjidhjen e këtij problemi do t'i kursejmë miliona euro për pacientët tanë dhe do të ofrojmë shërbime në çdo kohë, 24/7. Ky aparat do të mundësojë ofrimin e shërbimeve për sëmundje të

zemrës dhe enëve të gjakut. Po e bëjmë edhe një hap para për ofrimin e shërbimeve të nevojshme për qytetarët tanë. Të gjitha punët do të përfundojnë shumë shpejt dhe kjo pajisje do të vihet në shërbim të qytetarëve", ka thënë ministri Ismaili.

SBASHK-u, Bytyqit: Kujdes me mësimdhënësit e arsimit të mesëm të lartë

EPOKA ERE Arbisa SHEFKIU

PRISHTINË, 3 KORRIK - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) i ka bërë thirrje ministrit të Arsimit, Shyqyri Bytyqi, që të ketë kujdes me mësimdhënësit e arsimit të mesëm të lartë. Kjo sindikatë konsideron se anëtarët e tyre, të punësuar në arsimin e mesëm të lartë, nuk janë fajtor pse nuk u është dhënë mundësia e as hapësira për ta vazhduar ngritjen profesionale pa shkëputje nga puna e për ta arritur titullin master. "Prandaj pa ua krijuar në mënyrë institucionale këtë mundësi, si u veprua me ata që kishin Shkollën e Lartë Pedagogjike, nuk mund as të mendohet nga dikush që atyre t'u vihen në pikëpyetje vendet e punës, në të cilat janë me vite e dekada. Pas përgatitjeve të duhura në Fakultetet e Edukimit ishin dërguar në ngritje profesionale të gjithë të punësuarit në arsimin e mesëm të ulët, që nuk

kishin kaluar moshën 50 vjeç e që ishin me Shkollën e Lartë Pedagogjike. Ky aktivitet i ngritjes profesionale pa shkëputje nga puna është në përfundim e sipër", është thënë në komunikatën e SBASHK-ut. SBASHK-u ka bërë me dije se MASHT-i, gjegjësisht ministri i atëhershëm Arsimit Bajrami, kishte nxjerrë Udhëzimin Administrativ 06/2015 që ka të bëjë me Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, neni 12 i të cilit thotë se "pas përfundimit të vitit shkollor 2017-2018 shpallet konkursi për vende të lira pune për të gjithë kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret e kualifikimit si më lartë", që nënkupton se deri në këtë kohë të gjithë të punësuarit në arsimin e mesëm duhet ta kenë titullin master. SBASHK-u ka theksuar se me këto kuadro nuk është vepruar si me kolegët e tyre që kishin ShLP-në. "Këta nuk u dërguan me lista në Fakultetin e Edukimit për të vazhduar ngritjen profesionale e



për të ardhur te titulli master, prandaj nuk është e drejtë të vihet në zbatim nga DKA-të neni 12 i këtij Udhëzimi Administrativ", thuhet në komunikatën e kësaj sindikate. SBASHK-u ka njoftuar se që në

fillim ka alarmuar ministrin Bytyqi lidhur me këtë çështje dhe ka kërkuar nga ai të veprojë dhe shtyjë afatin që e ka përcaktuar ish-ministri Bajrami, si dhe të obligohet Fakulteti i Edukimit që të krijojë hapësirë, të caktojë

kuadro adekuate që do të punonin me të gjithë mësimdhënësit e arsimit të mesëm, që nuk janë më të vjetër se 50 vjeç në mënyrë që të gjithë të kenë mundësi për ngritje të duhur profesionale.

PSD-ja kërkon që Kuvendi i Kosovës ta mbikëqyrë dialogun

Nënkryetari i Partisë Socialdemokrate, Visar Ymeri, ka thënë se është e domosdoshme që Kuvendi i Kosovës do të jetë i përfshirë në procesin e dialogut me Serbinë. Ai ka thënë se legjitimiteti në këtë proces fitohet vetëm nëse Kuvendi është i përfshirë përgjatë gjithë dialogut. "Platforma duhet të miratohet në Kuvendin e Kosovës", ka thënë Ymeri



EPOKA
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 3 KORRIK - Përfaqësuesit e Partisë Socialdemokrate (PSD) kanë bërë me dije të martën se Kuvendi i Kosovës duhet ta marrë rolin drejtues dhe ta mbikëqyrë procesin e dialogut politik në mes të Kosovës dhe Serbisë që po lehtësohet nga Bashkimi Evropian (BE). Në një konferencë për media, nënkryetari i kësaj partie, njëherësh deputet, Visar Ymeri, ka thënë se është e domosdoshme që Kuvendi të jetë i përfshirë në këtë proces. "Legjitimiteti fitohet vetëm nëse Kuvendi është i përfshirë në këtë proces përgjatë gjithë dialogut. Platforma duhet të miratohet në Kuvendin e Kosovës. Ne si Parti Socialdemokrate konsiderojmë se përgjegjësia e institucioneve duhet të jetë e qartë për sa i përket procesit të dialogut, njëkohësisht e shohim të domosdoshëm dhe të pashmangshëm një rol drejtues dhe udhëheqës për sa i përket këtij procesi", ka thënë

Ymeri. Ai ka shtuar se kushdo që mendon që në këtë proces duhet të shkohet "pa vija të kuqe e ka gabim dhe paraqet rrezik të madh për mbarëvajtjen e këtij dialogu dhe për marrëveshjen përfundimtare". Rreth dialogut Kosovë - Serbi ka folur edhe deputeti i kësaj partie, Dukagjin Gorani. Ai ka thënë se Kuvendi i Kosovës me dy të tretat e votave duhet ta mandatojë bartësin apo bartësit e dialogut, duke shtuar se ata duhet t'i japin përgjegjësi Kuvendit të Kosovës. Gorani ka pohuar se presidenti i vendit, Hashim Thaçi, i cili po zhvillon raunde bisedimesh me homologun e tij serb, Aleksandar Vuçiq në Bruksel, nuk ka legjitimitetin popullor që të jetë në krye të këtij procesi. "Përfaqësimi është i rëndësishëm në këtë proces, pasi që posti i presidentit nuk buron nga legjitimiteti popullor, por është kompromis i politikave partiake brenda Kuvendit të Kosovës. Andaj, si i tillë, këtë post nuk mund ta kuptojmë si legjitim dhe për ne është i papranueshëm", ka thënë

Gorani. Ai ka propozuar që Kuvendi të formojë një komision të veçantë për mbikëqyrjen e dialogut. PSD-ja konsideron se para diskutimeve të panevojshme rreth formimit dhe përbërjes së të ashtuquajturit 'Grup i Unitetit' që do ta përfaqësonte shtetin tonë në këtë proces me rëndësi për vendin, duhet të përmbushen katër parakushtet e domosdoshme për çfarëdo pro-

cesi kuptimplotë negociator. PSD-ja konsideron se fillimisht duhet të përcaktohen dhe të saktësohen katër shtylla që e përkufizojnë përmbajtjen dhe qëllimin e një procesi të tillë: 1. Legjitimiteti: Kuvendi, forumi i vetëm i prodhimit të tij, 2. Strategjia: Qartësimi i parimeve negociuese dhe hartimi i dokumentit konsensual, 3. Përfaqësimi: Ndërtimi i mekanizmit parlamentar që

përzgjedhë mandatarin dhe ekipin negociator, 4. Mbikëqyrja e procesit: Opozita ta marrë rolin udhëheqës. Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë ka nisur që nga viti 2011. Sipas Bashkimit Evropian, në fund të këtij procesi të dy vendet duhet të arrijnë një marrëveshje për normalizimin e raporteve e cila, pos të tjerash, i çon të dyja vendet drejt integritimeve evropiane.

Hoxha: Procesi i integritimit është kompleks dhe kërkon shumë reforma

EPOKA
ERE **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, me kërkesë të Komisionit Parlamentar për Integritim Evropian, ka informuar të martën anëtarët e këtij komisioni për projektin për asistencë teknike të Luksemburgut, i cili është në kuadër të projektit të bashkëpunimit zhvillimor, asistencë teknike në kontekst të integritimit evropian. Ajo ka treguar se pas negociimit, më 7 mars të këtij viti është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit në kontekst të integritimit evropian me Qeverinë e Luksemburgut për mbështetje të institucioneve të Kosovës në ndërtimin e kapaciteteve për zbatimin e MSA-së në disa fusha prioritare dhe mbështetje për komunikim efektiv të procesit të MSA-së. "Asistencë ofrohet për trajnim, trajnim të trajnerëve, nevoja ad-hoc



për ekspertizë dhe politika të caktuara dhe hulumtime gjithëpërfshirës i politikave të BE-së për të ndihmuar në formulimin e politikave nacionale dhe përafrimin e legjislacionit", ka deklaruar Hoxha. Ministria Hoxha ka bërë me dije se fushat prioritare bazohen në pri-

oritetet e MSA-së dhe përfshijnë 10 fusha të politikave nga të cilat 9 kapituj të Acquis dhe një temë horizontale. Sipas saj, projekti planifikohet të realizohet për katër vjet, shumica e mbështetjes është 2.1 milion euro, nga të cilat Luksemburgu jep grant 2 milionë

euro, kurse bashkëfinancimi nga Ministria e Integritimit është 100 mijë euro. Hoxha ka thënë se projekti do të menaxhohet nga Komiteti i përbashkët drejtues (MIE, Luksemburg) dhe do të implementohet nga Ministria e

Integritimit. Po ashtu, ajo ka bërë me dije se projekti për zhvillimin e kapaciteteve në vlerë prej 1.5 milion eurosh është duke u negociuar me Qeverinë e Norvegjisë, për 9 kapituj të ri. Gjithashtu, ministria Hoxha ka thënë se procesi i integritimit është kompleks dhe kërkon reforma në shumë sektorë. "Ministria e Integritimit, në bashkëpunim me institucionet tona dhe partnerët, duke përfshirë Zyrën e BE-së, ka identifikuar një numër të fushave prioritare të MSA-së, të ashtuquajturit kapituj të Acquis, ku do të kontribuohet për forcimin e kapaciteteve. Qëllimi është zbatimi efikas i MSA-së në veçanti dhe agjendës së integritimit", është shprehur Hoxha. Ajo ka kërkuar të ofrohet mbështetje edhe për ministrat dhe komisionin sepse, sipas Hoxhës, asistencë për shërbimin civil duhet të koordinohet edhe me asistencë për nivelin politik për implementimin e MSA-së.

Sindikata e Doganës reagon për draftligjin e pagave




Dogana e Kosovës për gjashtë muaj mblodhi 504.3 milionë euro

PRISHTINË 3 KORRIK (ER) - Gjatë periudhës gjashtëmuajore (janar - qershor 2018) të hyrat e përgjithshme të inkasuara nga Dogana e Kosovës në total arritën vlerën prej rreth 504.3 milionë eurosh që, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017, paraqet një rritje prej 3.5 % apo rreth 17 milionë euro më shumë.

Sipas një njoftimi të Doganës, ndikim në të hyrat në import për këtë periudhë ka pasur efekti i MSA-së dhe pakove

fiskale që u referohen prodhuesve. "Duhet theksuar se ndikimi në të hyra nga MSA-ja përgjatë kësaj periudhe është rreth 21 milionë euro apo rreth 46.3 % më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ndërsa ndikimi në të hyra doganore nga pakoja fiskale që i referohen lirimit nga taksat në import për prodhuesit përgjatë periudhës raportuese është rreth 29.6 milionë euro. Edhe ndikimi në të hyra nga importi i veturave të përdorura, ku

vërehet një rënie e theksuar krahasuar me vitin e kaluar, kemi 5 335 copë vetura më pak dhe kjo ka ndikuar që të shënohet një rënie në të hyra prej 8.6 milionë eurosh më pak. Totali i ndikimeve negative në të hyra nga këto kategori për këtë periudhë është afër 60 milionë euro apo, shprehur në përqindje, rreth 12 % të totalit të të hyrave të grumbulluara nga Dogana e Kosovës për këtë gjashtëmuajor", është thënë në njoftimin e Doganës së Kosovës.



çdo kënd të territorit të vendit, 2. Të ruhen dhe avancohen pagat e zyrtarëve doganorë duke u bazuar në statusin,

specifikat doganore profesionalizmin, nivelet e organizimit doganor dhe dallimet në paga në mes secilit nivel, 3. Të mos

finalizohet pa i pasur parasysh vërejtjet, komentet dhe propozimet dhe pa i integruar ato në të.

EPOKA E RE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 KORRIK - Sindikata e Pavarur e Doganës së Kosovës ka reaguar ndaj iniciativës për kategorizimin e oficerëve doganorë në staf civil, duke vlerësuar se jo të gjithë të punësuarit mund të kenë detyra dhe përgjegjësi të njëjta dhe unifikim të përshkrimeve të vendit të punës. Po ashtu, është paralajmëruar se nëse situata në raport me Doganën nuk ndryshon, atëherë sindikata do t'i marrë të gjitha veprimet sindikale konform ligjeve, për ta mbrojtur interesin dhe mirëqenien e organizatës.

Përmes një njoftimi për media kjo sindikatë ka vlerësuar se kategorizimi i punonjësve të Doganës së Kosovës si shërbyes civil, ndryshimi i statusit të zyrtarëve doganorë, organizimit të Doganës së Kosovës do të ketë efekt të drejtpërdrejtë në rolin dhe misionin kompleks të Doganës në fushën e sigurisë kufitare, por edhe në mbledhjen

e të hyrave, ku Dogana dhe punonjësit e saj që nga themelimi vlerësohen lart për përbushjen e këtij misioni dhe objektivave të shtetit. "Duke pasur parasysh faktin që klasifikimi i paraqitur për pozitat doganore në aneks nuk përshkruhet me statusin, përgjegjësitë, kompleksitetin, rrethanat dhe kushtet në të cilat punojnë zyrtarët doganorë, të cilët janë dëmtuar në paga sipas draft propozimit të fundit nga grupi punues", është thënë në reagimin e Sindikatës së Pavarur të Doganës së Kosovës.

Kjo sindikatë ka kërkuar nga ministri i Administratës Publike, Mahir Jaghillar, sponsorues i këtyre draftligjeve dhe nga grupi punues, që t'i kenë parasysh propozimet e tyre: 1. klasifikimi/rangimi i koeficienteve të ketë pasur parasysh statusin e veçantë të zyrtarëve doganorë, kompleksitetin e punës së tyre, natyrën e punës në Doganë, kërkesat e punës për t'iu përgjigjur nevojave të shërbimit për punë në çdo kohë dhe në

Presidenti Thaçi dhe guvernatori Mehmeti flasin për punën e BQK-së

Prishtinë, 3 korrik (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të martën në takim guvernatorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmetin, i cili i ka dorëzuar presidentit raportin vjetor të punës së BQK-së për vitin 2017.

Presidenti Thaçi e ka përgëzuar guvernatorin Mehmeti dhe gjithë stafin e BQK-së për punën që janë duke e bërë në ruajtjen e stabilitetit financiar dhe në mbështetjen e politikave të

përgjithshme ekonomike të Qeverisë së Kosovës.

Ndërsa guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, e ka falënderuar presidentin Thaçi për mbështetjen që i ka dhënë BQK-së, duke e informuar atë për punën e deritashme dhe prioritet për vitet e ardhshme.

Presidenti Thaçi ka thënë se Banka Qendrore duhet ta vazhdojë punën e saj bazuar në parimet e ekonomisë së tregut të hapur dhe konkurrencës së lirë.



Lluka paralajmëron formimin e një grupi ekspertësh për hetimin e kontratave të dëmshme

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, në tryezën e organizuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur, me temë "Kontratat e dëmshme të Kosovës: Kush ka faj?", ka theksuar se ndër arsyet kryesore që Kosova është dëmtuar nga kontratat e mëdha është mungesa e profesionalizmit dhe përfaqësimi joadekuat në arbitrazh

EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 3 KORRIK - Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Valdrin Lluka, ka marrë pjesë të martën në tryezën e organizuar nga Fondacioni për Shoqëri të Hapur me temën "Kontratat e dëmshme të Kosovës: kush ka faj?"

Ai në këtë tryezë ka theksuar se ndër arsyet kryesore që Kosova është dëmtuar nga kontratat e mëdha është mungesa e profesionalizmit dhe përfaqësimi joadekuat në arbitrazh. "Kontratat janë të bëra me profesionalizëm. Problemi është se Qeveria ka hyrë në marrëdhënie kontraktuale pa pasur buxhetin e paraparë. Ligji për prokurim publik obligon posedimin e mjeteve kur ta nënshkruajë kontratën. Problemi qëndron te qëndrimi karshi kontratës për të cilën jemi zotuar. Një pjesë e madhe e fajit është edhe përfaqësimi në arbitrazh. Për shembull, rasti me AXOS-in është rast që kemi fituar, mirëpo ku përfaqësohemi nga kompanitë ven-

dore nuk dalim fituese", ka thënë ai.

Ministri Lluka ka shtuar se ndërmarrjet publike janë ndër sfidat më të mëdha që Kosova ka sot. "Janë kontratat më të dëmshme që janë nënshkruar pikërisht në këto ndërmarrje. Ne jemi duke bërë një grup me juristët më të mirë që i ka Kosova, ku do të bëhet një analizë për Telekomin për 15 kontrata që janë nënshkruar e nuk zbatohen. Ato sillen nga 600 mijë euro deri në 10 milionë euro. Ideja e kësaj është ta pastrojmë Telekomin nga këto kontrata dhe të shikojmë se si mund ta rikonstruojmë Telekomin dhe këto janë probleme që po shfaqen nga mosdija dhe keqpërdorimi i mundshëm. Gjatë muajit korrik komplet do të organizohet, ndërsa gjashtë muaj është koha kur do të analizohen këto kontrata", ka thënë Lluka.

Kurse drejtori ekzekutiv i Institutit Riinvestit, Alban Hashani, ka prezantuar një studim të hartuar nga ky institut, ku ka përmendur mungesën e transparencës dhe profesional-



izmit. Ai ka kërkuar ngritje të rolit të prokurorisë në këtë aspekt si dhe të atij të Kuvendit. Hashani ka përmendur edhe mangësitë kryesore të kontratave. "Së pari, vërehet qartë se ka mungesë të profesionalizmit në dizajnimin e kontratave publike, së dyti, ka mungesë të theksuar të transparencës dhe, së treti, ka dyshime dhe vërtetime të keqpërdorimit të pozitës zyrtare", është shprehur

Hashani.

Në mungesë të ministrit të Infrastrukturës Pal Lekaj, ka folur zëvendësministri Fehmi Mujota, i cili ka thënë se secila qeveri duhet t'i zbatojë kontratat që merr nga qeveria paraprake, në të kundërtën mund të shkaktojë dëme. Ai ka thënë se problemi i kontratës së "Bechtel Enkas" është investimi te projektet e vogla.

Deputeti i Kuvendit të Kosovës,

Korab Sejdiu, ka thënë se Qeveria ka përgjegjësi ndaj publikut, kurse kompania private nuk ka përgjegjësi për parane publike. Sipas Sejdiut, klauzola e konfidencialitetit nuk duhet të ketë vend në kontrata publike. "Për mua është shumë e pakuptimtë kur një ministër ose një qeveri e merr një vendim pa e marrë mendimin e një kompanie e cila po paguhet diku tetë milionë euro", është shprehur Sejdiu.

ANP 'Adem Jashari' shpallet fitues i çmimit për biznes të përgjegjshëm

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Në ceremoninë e mbajtur nga "Peer Awards for Excellence" në Londër të Mbretërisë së Bashkuar,

Aeroporti Ndërkombëtar të Prishtinës i është dhënë çmimi për Biznes të Përgjegjshëm për impaktin e kompanisë në shoqërinë e vendit ku operon.

Përkushtimi i vazhdueshëm ndaj mbrojtjes së ambientit, duke përfshirë zvogëlimin e emetimit të dyoksidit të karbonit, trajtimin e ujërave dhe të mbetjeve, proceset transparente të rekrutimit, shërbimet e reja me ndikim në rritjen e kënaqshmërisë së udhëtarëve si "Airport Helper", si dhe implementimi i sistemeve më të avancuara të sigurisë dhe i atyre për trajtimin e aeroplanëve dhe udhëtarëve, kanë qënë pikat e vlerësuar nga juria që e kanë vendosur ANP



"Adem Jashari" në listën e kompanive më të përgjegjshme ndaj shoqërisë.

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari" tashmë për disa vjet qëndron

në listën e aeroporteve me performancën më të lartë në Evropë, me ç'rast ka pranuar

dhjetëra çmime për efikasitet në operime dhe përgjegjësi korporative.

Në Ohër u mbajt konferencë shkencore ndërkombëtare

OHËR, 3 KORRIK (ER) - Nën organizimin e Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, Universiteteve Marmara dhe Balikesir nga Turqia, Fakulteti i Turizmit në Ohër dhe me Young Scholar Union nga Turqia, më 27 dhe 29 qershor në Ohër të Maqedonisë është mbajtur konferenca e tretë shkencore ndërkombëtare me titull "The West of dhe East, the East of dhe West".

Kryesues i konferencës ishte rektori i UPZ-së, Ramë Vataj, gjithashtu organizatorët prej UPZ-së, prof. Serdan Kervan, nga Universitetit i Marmarase ishte Mehmet Aça, nga Universiteti i Balikesirit, Erdogan Tezci dhe përfaqësues nga Young Scholar Union, Tugrul Aktas.

Rektori Vataj dhe përfaqësuesit e universiteteve dhe institucioneve të tjera partnere e vlerësuan lart organizimin e kësaj konference, përderisa me



punimet e tyre studiuesit kanë dhënë kontribut konkret në fushat përkatëse.

Në konferencë kanë marrë

pjesë 75 pjesëmarrës nga Turqia, Kosova, Shqipëria, Italia dhe Maqedonia. Fushat e studimeve të prezantuara ishin

nga: edukimi, historia, komunikimi medial, kinemaja, televizioni, juridiku, letërsia, marrëdhëniet publike.

Ka filluar rregullimi i rrugëve edhe në lagjet e Rashanit në Mitrovicë

MITROVICË, 3 KORRIK (ER) - Drejtoria e Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike në Mitrovicë ka shtuar punët në rregullimin e infrastrukturës rrugore në këtë komunë. Përveç projekteve në realizim e sipër për asfaltimin dhe kubëzimin e rrugëve, që kanë filluar më parë e që janë dhjetëra sosh, këto ditë kanë filluar edhe projekte të tjera të ndërtimit të rrugëve nëpër fshatra.

Drejtori i kësaj drejtorie, Naser Muja, ka inspektuar punimet në hapjen dhe ndërtimin e rrugëve nëpër lagjet e shkapërderdhura



të Rashanit, që është duke i kryer kompania "Haxha Com". Në lagjet Sumiqi dhe Smakolli, drejtori Muja u ka thënë banorëve se komuna është duke bërë përp-

jesë 75 pjesëmarrës nga Turqia, Kosova, Shqipëria, Italia dhe Maqedonia. Fushat e studimeve të prezantuara ishin

përmes Stantërgut dhe me Vushtrinë përmes Pasomës e Smrekonics dhe në këtë mënyrë ta kenë më të lehtë jetën që bëjnë aty.

Banorët e lagjeve Sumiqi dhe Smakolli falënderuan drejtorin Muja për rregullimin e disa kilometrave të rrugëve të lagjeve të fshatit, duke thënë se tani e tutje do ta kenë më lehtë të komunikojnë me Mitrovicën e Vushtrinë dhe të bëjnë jetë më të mirë e më të pabrenga. Drejtoria e Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike ka filluar edhe rregullimin e rrugës për në fshatin Cërnushë.

Në Malishevë digjen tri parcela me grurë

MALISHEVË, 3 KORRIK - Policia e Kosovës (PK) ka njoftuar se në fshatin Joviq të Malishevës tri parcela me grurë janë përfshirë nga zjarri, në sipërfaqe prej 16 ari. Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitet përkatëse dhe zjarrfikësit, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Digjet një fabrikë në Drenas

DRENAS, 3 KORRIK - Një fabrikë në Korreticë të Epërme të Drenasit është përfshirë nga zjarri në rrethana ende të panjohura. Njësitë përkatëse dhe zjarrfikësit kanë dalë në vendin e ngjarjes duke lokalizuar zjarrin. Përveç dëmeve materiale, nuk raportohet për lëndime në njerëz, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Arrestohet një qytetar serb pasi rrahu bashkëshorten

RAHOVEC, 3 KORRIK - Në Komunën e Rahovecit është arrestuar një qytetar i komunitetit serb, i cili, nën ndikimin e alkoolit, ka sulmuar fizikisht bashkëshorten e tij duke i shkaktuar lëndime trupore. Viktima ka pranuar trajtim mjekësor, ndërsa i dyshuari me vendim të prokurorit është dërguar në mbajtje, ka njoftuar Policia e Kosovës.

Mitrovica cakton hapësirë të posaçme për shitësit e pjeprave

MITROVICË, 3 KORRIK (ER) - Nën udhëheqjen e kryetarit të Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, në të cilën ishin të pranishëm drejtorët e drejtorive të administratës komunale.

Anëtarët e Bordit i dhanë përkrahje të plotë Drejtorisë së Inspeksionit për të vënë rend e rregull në rrugën "Vëllezërit Dragaj", përkatësisht për t'i larguar nga kjo rrugë shitësit e mallrave të ndryshme të cilët po e pengojnë lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Duke pasur parasysh interesin e bujqve, anëtarët e Bordit u pajtuan që për shitësit e pjeprave, prodhim ky që nuk është shumë i

qëndrueshëm dhe mund të prishet shpejt dhe sezoni i të cilëve zgjat për afërsisht një muaj, të caktohet një lokacion i posaçëm në hapësirën afër xhamisë kryesore në qendër të qytetit.

Pjesë dërrmuese e pikave të tjera të rendit të ditës ishin nga fushëveprimi i Drejtorisë së Financave, e cila kërkoi nga drejtoritë e tjera që t'i sjellin sa më shpejt planifikimet buxhetore dhe propozimet për ndryshimet në rregulloret e caktuara. Ndërkaq kryetari Bahtiri ka kërkuar të përgatitet një pasqyrë e realizimit të të ardhurave nga tatimet komunale në mënyrë që të shihet se ku mund të veprohet dhe bizneset të lirohen nga tatimet.



TIKA rinovon shkollën "Elena Gjika" në Prishtinë

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Komuna e Prishtinës dhe Agjencia Turke për Bashkëpunim dhe Koordinim (TIKA) kanë nënshkruar të martën një memorandum bashkëpunimi për realizimin e projektit të rinovimit dhe pajisjes me inventar të shkollës fillore "Elena Gjika" në kryeqytet. Me këtë rast, kryetari i Komunës së Prishtinës,

Shpend Ahmeti, ka bërë me dije se sipas këtij memorandum do të rinovohet komplet kjo shkollë. "Shkolla 'Elena Gjika' ka qenë në një gjendje të rëndë sa i përket gjendjes infrastrukturore. Kemi gjetur mbështetjen ta rinovojmë me TIKA-n. I nënshkruam dy marrëveshjet e para për rinovimin dhe pajisjen me inventar të ri për komplet shkollën. Punimet do të

zhvillohen me procedura të përsheptuara të agjencisë dhe synojmë që në shtator shkolla të jetë e rinovuar", ka thënë Ahmeti.

Ndërsa shefi i zyrës së TIKA-s në Kosovë, Hasan Burak Ceran, ka shprehur besimin se rinovimi i shkollës do të bëhet me kohë. Më shumë se 50 për qind e rinovimit të "Elena Gjikes" do të mbështetet nga TIKA.



Në tetor priten konkluzionet e hetimit rreth dëbimit të shtetasve turq

PRISHTINË, 3 KORRIK - Nga mesi i muajit tetorit të këtij viti pritet që komisioni hetimor parlamentar t'i paraqes konkluzionet zyrtare të Kuvendit të Kosovës në lidhje me dëbimin e gjashtë shtetasve turq nga Kosova për në Turqi. Kështu, të paktën kanë paralajmëruar nga komisioni i sapoformuar hetimor në Kuvend.

Komisioni hetimor, i cili është propozuar nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe ka marrë mbështetjen e partive parlamentare, parashihet t'i hetojë dhe ndriçojë rrethanat dhe procedurat e dëbimit të gjashtë shtetasve turq nga Kosova për në Turqi.

Më 29 mars të këtij viti, me kërkesë të autoriteteve turke, Policia e Kosovës ka arrestuar dhe dëbuar për në Turqi gjashtë qytetarë turq, pesë prej tyre punonjës në shkollën "Mehmet Akif", ndërsa i dëbuar i gjashtë mjek.

Pas këtij zhvillimi, Kuvendi i Kosovës, më 17 prill, kishte miratuar një rezolutë për themelimin e një komisioni hetimor lidhur me dëbimin e këtyre shtetasve të Turqisë.

Xhelal Sveçla, kryetar i Komisionit Hetimor nga Lëvizja Vetëvendosje, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë" ka thënë se gjatë kësaj jave priten konsolidimi i stafit të komisionit si dhe pajisja me dokumentacione të nevojshme. Pas kësaj periudhe, tha ai, priten hapat e veprimit në



aspektin e dëshmiave dhe dëgjimin e personave të përfshirë në këtë çështje.

Sveçla ka thënë se ky komision do ta japë epilogun përfundimtar, pavarësisht faktit që ka, sipas tij, përpjekje nga qarqe të caktuara për ta penguar këtë proces. "Me vetë faktin që ky komision po filon punën dy muaj me vonësë është një pengesë në vete.

Vërehet një intencë e qarqeve të caktuara që ta defunkcionalizojë punën e këtij komisioni apo që ta vështirësojë punën. Por, ne jemi të vendosur ta shtyjmë përpara këtë çështje. Mendojmë se është jashtëzakonisht e rëndësishme. Meqenëse, sipas mendimit tim, ajo që ka ndodhur atë ditë është pika më e zezë e veprimit institucional që nga shpallja e pavarë-

sisë e deri më tash", ka deklaruar Sveçla.

Hetime lidhur me dëbimin e shtetasve turq ka bërë edhe Avokati i Popullit në Kosovë, Hilmi Jashari, sipas të cilave, janë konstatuar shkelje të standardeve ndërkombëtare dhe lirive të njeriut. Ky raport me rekomandime të publikuar u është dorëzuar institucioneve kompetente.

Jashari ka theksuar për "Radion Evropa e Lirë" se ende është në pritje të një përgjigjeje zyrtare nga Qeveria e Kosovës. Sipas tij, në bazë të të gjeturave gjatë hetimeve shtetasit turq nuk janë dëbuar, por janë ekstraduar nga Kosova. "Çdo vonësë e mëtejme e komplikon procesin sepse mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë, kam dëgjuar, se kanë filluar ta trajtojnë këtë çështje. Tashmë kjo çështje tejkalon nivelin vendor", është shprehur Jashari.

Deportimi i gjashtë shtetasve turq nga Kosova për në Turqi ishte një aksion i koordinuar ndërmjet shërbimeve të inteligjencës nga Turqia dhe Kosova. Por, që deputetët, presidenti, kryeministri dhe kryetari i Kuvendit patën deklaruar se nuk kishin fare njohuri lidhur me rastin.

Kryeministri Haradinaj pati liruuar nga detyra ministrin e Brendshëm, Flamur Sefaj dhe shefin e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Driton Gashi, të cilët, më pas kanë dhënë dorëheqje nga pozitat e tyre. Pas kësaj, në muajin maj, familjarët e shtetasve turq kanë ngritur padi kundër institucioneve përgjegjëse ndaj vendimit për urdhërlargimin e tyre me forcë dhe për revokimin e lejeqëndrimit të gjashtë shtetasve turq. Ndërsa tashmë janë duke përgatitur dosje për ta dërguar çështjen edhe në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

"Dekada" nga Jeton Krasniqi sjell dashurinë për rep muzikën

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Një dekadë përkushtim, shpirt, vuajtje e kënaqësi në kabinën e muzikës. Aty ku emocionet e hidhura e të lumtura rrjedhin në mikrofon nga reperi Jeton Krasniqi, i njohur si "Jeto1", më parë si "Rap J".

"Jeto1" që dhjetë vjet rep muzikën e feston me publikimin e albumit të pestë me titull "Dekada", në të cilën shihet një laramani e këngëve. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se ky album përmban 21

këngë. Ai ka treguar se këtë album e bën të veçantë llojllojshmëria e temave që janë trajtuar. "Ka këngë për jetën, për klube, dedikime e bashkëpunime me shokë që e kemi nisur bashkë muzikën. Kurse sot secili këndojmë për argëtim. Bashkëpunimet me reperët e rinj, të cilët më kanë befasuar me talentin e tyre, shpresoj se edhe të tjerëve do t'u pëlqejë albumi pasi ka këngë për të gjitha shijet. Pra, kjo është e veçanta e këtij albu-

mi", ka deklaruar reperi nga Rahoveci. Ai ka bërë me dije se në këtë album ka punuar përreth gjashtë muaj, duke shtuar se në secilën këngë është një pjesë e shpirtit të tij.

Në këtë album ai ka veçuar këngën dedikuar nënës dhe disa këngë të tjera që kanë të bëjnë me jetën në Kosovë. "Ana e fuqishme në këngët e mia janë tekstet, megjithatë edhe interpretimi ka rëndësinë e vet, por për këtë le të gjykojnë të tjerët", ka deklaruar Krasniqi.



Pompeo viziton Korenë e Veriut

UASHINGTON, 3 KORRIK - "Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, do të udhëtojë këtë të enjte drejt Phenjanit, për të biseduar me udhëheqësin e Koresë së Veriut, Kim Jong Un, rreth denuklearizimit të këtij vendi". Kështu është

bërë me dije në njoftimin e Shtëpisë së Bardhë. Kjo do të jetë vizita e parë e Pompeo në Kore të Veriut që nga takimi, më 12 qershor, midis presidentit amerikan Donald Trump dhe homologut të tij verikorean, në të cilin ky i fun-

dit është pajtuar "për të punuar drejt denuklearizimit të Gadishullit Korean". "Për ta vazhduar punën e rëndësishme rreth denuklearizimit, sekretari Pompeo do të udhëtojë në Kore të Veriut më 5 korrik, për ta takuar liderin veriko-

rean dhe ekipin e tij", ka thënë zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders. Pas Phenjanit, Pompeo do të udhëtojë në Tokio dhe Pjongjang, për të diskutuar të njëjtën çështje me zyrtarët japonezë dhe jugkoreanë.



Trumpi i 'qorton' aleatët e NATO-s

UASHINGTON, 3 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA), Donald Trump, u dërgoi një letër udhëheqësve të disa aleatëve të NATO-s, përfshirë Belgjikën, Kanadanë, Gjermaninë dhe Norvegjinë, duke i paralajmëruar se po shpenzojnë shumë pak në mbrojtje, raporton gazeta "New York Times". Sipas saj, Trumpi po ashtu tërheq vërejtjen se ShBA-ja është gjithnjë e më e zhgënjyer me dështimin e tyre, për t'i përmbushur detyrimet e sig-

urisë, të ndara nga aleanca ushtarake.

Trump vazhdimisht i ka kritikuar anëtarët e NATO-s që shpenzojnë më pak se 2 për qind të bruto prodhimit të tyre të brendshëm në mbrojtje. Tensionet midis ShBA-së dhe disa aleatëve të NATO-s janë rritur në prag të një samiti të NATO-s që do të mbahet më 11 dhe 12 korrik në Bruksel. Ky samit do të pasohet me një takim midis Trumpit dhe presidentit rus, Vladimir Putin, në Helsinki, më 16 korrik.



OKB-ja i bën thirrje Jordanisë t'i hapë kufijtë për refugjatët sirianë

AMMAN, 3 KORRIK - Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR) i ka bërë thirrje Jordanisë t'i hapë kufijtë për sirianët që tentojnë të largohen nga konflikti i përshkallëzuar në rajonin jug-perëndimor, Deraa. Mesatarisht 270 000 persona

kanë ikur si pasojë e sulmeve ajrore dhe tokësore në dy javët e fundit, kanë njoftuar të hënën Kombet e Bashkuara. "Ne i bëjmë thirrje Qeverisë së Jordanisë t'i mbajë kufijtë e hapur për shtete të tjera në rajon dhe t'i pranojë civilët që kanë ikur nga vendi i tyre", ka

thënë zëdhënësja e OKB-së për të Drejta të Njeriut, Liz Throssell. Zëdhënësi i UNHCR-së, Andre Maheçiq, ka thënë se është vlerësuar se 40 000 sirianë janë mbledhur afër kufirit me Jordaninë, vendi i cili tashmë ka pranuar 650 000 refugjatë sirianë.

Mbijeton Qeveria e Merkelit

BERLIN, 3 KORRIK - Ministri i Brendshëm i Gjermanisë, Horst Seehofer, ka bërë me dije se nuk do të japë dorëheqje. Ky vendim i tij ka ardhur pas disa orë bisedimesh me kancelaren Angela Merkel. Ai ka thënë se dy partitë konservatore në koalicionin qeverisës janë pajtuar se si ta parandalojnë migrimin e paligjshëm përgjatë kufirit me Austrinë. Seehofer më herët ishte kërcënuar se do të largohet, por ka theksuar se është rënë dakord për kontrollë më të rrepta kufitare. Po ashtu, Merkel ka thënë se është gje-

tur një kompromis i mirë. Seehofer udhëheq Bashkimin Kristian Social, partinë simotër bavareze të Demokristianëve të Merkelit. Seehofer ka kërkuar të drejtën për t'i kthyer prapa migrantët e paligjshëm në kufirin e Bavarisë, por Merkel e mbrojt një marrëveshje të arritur me Bashkimin Evropian. Javën e kaluar BE-ja u pajtua për ngritjen e të ashtuquajturave qendra transiti, nga të cilat njerëzit që kanë kërkuar azil në një vend tjetër të BE-së mund të kthehen prapa në pikën e tyre të mbërritjes, nëse shteti tjetër pajtohet.




Mbi 1 000 njerëz janë mbytur në Mesdhe këtë vit

TRIPOLI, 3 KORRIK - Mbi 1 000 njerëz janë mbytur në Detin Mesdhe këtë vit, duke lundruar nga Libia për në Evropë, bëri me dije Organizata Ndërkombëtare për Migrim. Rreth 204 veta kanë vdekur vetëm në ditët e fundit, pasi

kontrabanduesit i futën në anije të pasigurta, tha organizata. Sipas saj, kontrabanduesit po i bindin migrantët ta kalojnë detin, duke u thënë se pritet të vihen kontrollë më të mëdha në Mesdhe në ditët në vijim. Fluksi i migrantëve është shumë më i

vogël se në vitin 2015, kur mijëra njerëz kanë kaluar detin nga Afrika e Veriut për në Evropë. Rruga tjetër, nga Turqia për në Greqi, e cila është përdorur nga mbi një milion njerëz në vitin 2015, është mbyllur dy vjet më parë.



Suksesi i Bebe Rexhës nuk ndalet



Bebe Rexha vazhdon të publikojë projekte të reja muzikore nga albumi i ri "Expectations". Ajo ka sjellë këngën "Sad" që u dedikohet mendimeve që ka njeriu sa herë që qëndron në vetmi. Së bashku me të

ka publikuar edhe "Pillow". E përkthyer në shqip "Sad" do të thotë "e mërzitur". Tekstet janë shkruar nga vetë artistja dhe mund të kenë lidhje me gjendjen e saj emocionale, por ende nuk është konfirmuar diçka e tillë.

Dafina Zeqiri rikthehet e "nxehtë" me "Fuego"



Pas një periudhe të gjatë pushimi, Dafina Zeqiri është rikthyer më e "nxehtë" se kurrë me një këngë të re që pritet të kthehet në hit veror. Këngëtarja

kosovare ka publikuar videoklipin e "Fuego". Ashtu siç edhe ka kuptimin fjala "fuego", zjarr, Dafina, përveçse ka mahnitur me zërin e saj, ajo shfaqet tepër provokuese në klip.



Beyoncé, pushime me familjen

Pas incidentit të një dite më parë në skenë, ku pa dashje zbuloi të pasmet, Beyoncé ka lënë pas gjithçka. Ajo ka postuar fotografi nga pushimet me familjen, përkatësisht me

bashkëshortin dhe vajzën gjashtëvjeçare Blu Ivy. Binjakët duket se nuk ishin pjesë e këtij udhëtimi. 36-vjeçarja dukej e mrekullueshme veshur me një fustan veror plot ngjyra.

Snoop Dogg investon në kompani farmaceutike

Snoop Dogg është një ndër këngëtarët më të famshëm amerikanë në rruzullin tokësor. Artisti njihet edhe për një jetë ç'thurur dhe me plot skandale kur bëhet fjalë për narkotikët. Ai kurrë nuk e ka fshehur faktin se është adhurues i madh i marijuanës si llojeve të tjera të drogës, por që nuk dihet nëse i konsumon të gjitha. Snoop do të investojë deri në 10 milionë dollarë në "Oxford Cannabinoid Technologies", një kom-



pani ndërkombëtare farmaceutike, e cila po fillon përdorimin e kanabisit në përbërjen e ilaçeve.

E rrallë

Drejtori çon tanke në shkollë për t'i 'motivuar' nxënësit

Për t'i motivuar studentët që të mësojnë shumë dhe të luftojnë për të ardhmen e tyre, një shkollë private në Kinë çoi dy tanke. Shkolla në qytetin Hebei është e rreptë dhe drejtori i shkollës kërkon që studentët e tij të dalin më të mirët në vend për provimet e maturës.



FOTO E DITES



Bukuritë e plazhit të Ksamilit, Shqipëri. / Foto: Granit Dinaj/

E jashtëzakonshme

Mahnitëse, kur 19 mijë avionë janë në qiell

FlightRadar24 ka ndarë në faqen e vet në "Twitter" pamjet e mahnitshme të ditës më të ngarkuar të fluturimit. Pamjet e mahnitshme tregojnë më shumë se 202 mijë avionë që kalojnë tokën në një ditë të vetme. Në video shihet si avionët pothuajse mbulojnë qiellin në një



det të verdhë. "Në kulmin e ditës (më 1 korrik), mbi 19 mijë avionë ishin në ajër në të njëjtën kohë", thuhet në postimin e FlightRadar24.

BARSOLETA E DITËS



Një polic i thotë shokut se do të niset për pushime në diell.
- Kam qejf të vij edhe unë, -ia pret shoku, po si do t'ia bëjmë nxehtësisë?
- Mos ki merak, do të udhëtojmë natën.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetëm gjate vikendit në ora 15:00

"AVENGERS: Infinity War" 3D,

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 29 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Hemsworth, Mark Ruffalo, Chris Evans, Scarlett Johansson, Tom Holland, Zoe Saldana, Josh Brolin, Chris Pratt, etj.

Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 18:00

"ISLE OF DOGS"

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 41 min

Rolet: F. Murray Abraham, Bryan Cranston, Greta Gerwig, Jeff Goldblum, Akira Ito, Scarlett Johansson, Harvey Keitel, Frances McDormand, Bill Murray, Yoko Ono, Liev Schreiber, Fisher Stevens, Tilda Swinton, etj.

Regjia: Wes Anderson



Në ora 16:00 dhe 20:00

"DEADPOOL 2" (R)

Aksion/Aventurë/Komedi; 1 ore 59 min

Rolet: Ryan Reynolds, Josh Brolin, Morena Baccarin, Julian Dennison, Zazie Beetz, T.J. Miller, Brianna Hildebrand, Jack Kesy, etj.

Regjia: David Leitch

Gjate vikendit 19 dhe 20 maj, "DEADPOOL 2" do të shfaqet në ora 13:00 dhe 20:00.



Në ora 22:00

"I FEEL PRETTY"

Komedi; 1 orë 50 min

Rolet: Amy Schumer, Michelle Williams, Rory Scovel, Emily Ratajkowski, Aidy Bryant, Busy Phillips, Tom Hopper with Naomi Campbell, Lauren Hutton, etj.

Regjia: Abby Kohn & Marc Silverstein

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Sot jeni të përfshirë në ndjenja dhe


emocione të thella karshi një personi të caktuar. Nuk po i kushtoni rëndësi asnjë gjeje rreth jush.



DEMI

Keni nevojë për meditim sot dhe doni

të rrii të izoluar larg zhurmës. Po mendoni për një vend ideal ku mund ta qetësoni shpirtin dhe mendjen.



BINJAKËT

Sot fusha e privilegjuar e jetës suaj

është miqësia. Në çdo moment do t'u përkushtoheni miqve tuaj për t'u treguar se sa vlerë kanë për ju.



GAFORRJA

Jo vetëm do të ëndërroni sot, por do

të bëni realitet një udhëtim të këndshëm. Jeni duke menduar një udhëtim të shkurtër.



LUANI

Shumë flirte parashikohen sot për ju

dhe një natë pasioni mbase me një person të huaj. Kryqëzoni gishtat për të ardhmen.



VI RGJËRESHA

Mbani nën fre fantazitë tuaja sot

sepse mund të ikni shumë larg realitetit. Kjo gjë do t'ju dëmtojë disi sepse nuk do jeni të vëmendshëm gjatë ditës.



PESHORJA

Shumë nga dita juaj do të varet sot me

humorin që do të zgjoheni. Nëse jeni optimistë çdo gjë do të shkojë më së miri.



AKREPI

Jeni mjaft ekspresive dhe kreativiteti

juaj vërehet ngado si në çështjet që kanë të bëjnë me punë, edhe në ato familjare.



SHIGJETARI

Nuk jeni shumë i kthjellët në gjykime sot

dhe kjo ka të bëjë me një ndjenjë paragjykimi që keni për një person të caktuar.



BRICJAPI

Jeni disi të ndrojtur në shprehjen e

mendimeve tuaja, por sot duhet të jeni ju ai që vendosni për mbarëvajtjen e një projekti të caktuar.



UJORI

Sot do të jetë e thjeshtë të flisni për

dashurinë dhe të shkëmbeni energji pozitive me partnerin. Dita do të vazhdojë e qetë dhe e këndshme.



PESHQIT

Komunikimi i mirë është ai që do të

lejojë të ecësh ose jo në karrierë. Çdo gjë varet sot në mënyrën se si do t'i menaxhoni kontaktet tuaja.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

FC INTER - KUPS

2

ROPS - FC ILVES

GG

VPS VAASA - TPS

1

MKRS-ja, 250 mijë euro për futbollin

"Kjo mbështetje financiare për Federatën e Futbollit bëhet me qëllim që Federata të ketë mundësi ta realizojë programin e saj për vitin 2018. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do të vazhdojë mbështetjen financiare të sportit dhe federatave në vend, sepse duke mbështetur financiarisht federatat dhe sportistët, po realizohen politikat programore për sportin", ka thënë Kujtim Gashi

PRISHTINË, 3 KORRIK (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi dhe nënkryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi në mes të MKRS-së dhe FFK-së. Sipas këtij memorandum, Federata e Futbollit do të mbështetet financiarisht me mbi 250 mijë euro nga ana e Ministrisë së Sportit. Kjo mbështetje financiare bëhet me qëllim të realizimit të objektivave dhe synimeve të Federatës për vitin 2018, përkatësisht për realizimin e politikave programore për avancimin e sportit femëror, për mjekësinë sportive, për avancimin e sportit cilësor, për zhvillimin e aktiviteteve sportive të karakterit ndërkom-bëtar brenda dhe jashtë vendit, për zhvillimin e aktiviteteve sportive për minoritetet dhe sportin shumetnik, për zhvillimin e aktiviteteve sportive për personat me aftësi të kufizuara, si dhe për zhvillimin e kapaciteteve menaxhuese në kuadër të Komitetit Olimpik të Kosovës dhe Federatave të



sportit.

Ministri Gashi ka thënë se ky memorandum u nënshkrua në pajtim me dispozitat e Ligjit për Sport dhe akteve të tjera nënligjore të përcaktuara nga MKRS-ja. "Kjo mbështetje financiare për Federatën e Futbollit bëhet me qëllim që Federata të ketë

mundësi ta realizojë programin për vitin 2018. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit do ta vazhdojë mbështetjen financiare të sportit dhe federatave në vend, sepse duke mbështetur financiarisht federatat dhe sportistët po realizohen politikat programore për sportin", ka

thënë Gashi.

Ndërkaq nënkryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, u shpreh i kënaqur për nënshkrimin e këtij memorandum. Ai falënderoi ministrin dhe e përgëzoi për punën që po bën në mbështetje të sportit në vend.

SHKURT

Sigal Prishtina në Ligën e Kampionëve

Sigal Prishtina do të marrë pjesë edhe sivjet në Ligën e Kampionëve në basketboll. Edhe pse kampion u shpall Bashkimi, është Prishtina ajo që do ta përfaqësojë Kosovën në Ligën e Kampionëve. Kjo është hera e dytë që Prishtina merr pjesë në këtë garë. Prishtina do të jetë pjesë e raundit të parë kualifikues. Shorti për këtë fazë do të hedhet më 11 korrik në Zvicër. Në edicionin e kaluar, Prishtina u eliminua në fazën e parë eliminatorie të grupeve për të vazhduar në fazën e grupeve të FIBA Europe Cup.

Drita prezanton Mustafën

Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, e ka transferuar mesfushorin Zgjim Mustafën nga skuadra e Gjilanit. Mustafa ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me Dritën, kurse do të jetë i gatshëm për ndeshjen e Ligës së Kampionëve ndaj Malmos. "Mesfushori Zgjim Mustafa ka nënshkruar kontratë dyvjeçare me skuadrën tonë, ku u prezantua në stërvitjen e parë për përgatitjen e ndeshjes në Ligën e Kampionëve kundër Malmos", thuhet në njoftimin e Dritës.

Silva, Belgjikës: Brazili gjithmonë është favorit

Në çerekfinale të Kupës së Botës Brazili do të luajë ndaj Belgjikës. Kapiteni i Brazilit, Thiago Silva, ka thënë se brazilianët gjithmonë janë favorit. "Belgjika është shumë e fortë fizikisht dhe teknikisht. Ajo meriton të luajë në çerekfinale. Unë mendoj se në të gjitha ndeshjet, Brazili është favorit, por ne e dimë se kjo nuk është e mjaftueshme. Ne duhet të punojmë shumë dhe të japim gjithçka, më të mirën, në qoftë se duam ta fitojmë titullin. Ne do të vazhdojmë të punojmë dhe të pushojmë, sepse ndeshja e së premtes do të jetë edhe më e vështirë", ka thënë Silva.

Presidenca dekoron Fadil Vokrrin me Medaljen Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë

PRISHTINË, 3 KORRIK - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, e ka dekoruar me Medaljen Presidenciale Jubilare të Dhjetëvjetorit të Pavarësisë, pas vdekjes, ish-kryetarin e Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrrin. Me motivacion kontributin e dhënë të Fadil Vokrrit për promovimin e sportit të Kosovës në botë dhe për anëtarësimin në UEFA dhe FIFA, presidenti dekoratën ua ka dorëzuar bashkëshortes dhe dy djemve të Vokrrit. Thaçi ka thënë se vdekja e Fadil Vokrrit ishte një humbje e madhe për familjen, bashkëpunëtorët, qytetarët dhe sportin kosovar. "Aty ku ishte Fadili, ishte fytyra e Kosovës. Të gjithë jemi të pikëlluar me vdekjen e Fadilit, por në të njëjtën kohë jemi krenarë për rolin e tij historik në promovimin e Kosovës në botë", ka thënë presidenti Thaçi.



Kreu i shtetit ka shtuar se në kohët më të rëndësishme Fadil

Vokrrin ka ndihmuar në zhvillimin e futbollit dhe në ngrit-

jen e imazhit të Kosovës në botë.

Lazio prezanton Valon Berishën

ROMË, 3 KORRIK - Valon Berisha është zyrtarisht pjesë e Lazios. 25-vjeçari kishte arritur marrëveshje me skuadrën nga kryeqyteti i Italisë, megjithatë sot ka ardhur dhe prezantimi nga ana e klubit. Ashtu siç pritej, mesfushori ka nënshkru-

ar një kontratë pesëvjeçare me skuadrën e Lazios. Berisha nga viti është aktivizuar te skuadra austriake e Salzburgut, por tani ka bërë një hap të madh, duke kaluar në Serinë A. Edhe një herë tjetër Lazio tregon se beson shumë te shqiptarët, kjo

ndoshta edhe për shkak se është Igli Tare ai që "dirigjon" lëvizjet në merkato. Mesfushori i Kosovës do të përfitojë 1.3 milion euro në sezon. Në garë për shërbimet e lojtarit të lindur në Suedi ishte edhe Sampdoria.



Eliminohet Zvicra e shqiptarëve

Valon Behrami, Granit Xhaka, Xherdan Shaqiri dhe Blerim Xhemali, së bashku me pjesën tjetër të reprezentacionit të Zvicrës, janë eliminuar nga Kupa e Botës. Paraqitja e zviceranëve ka qenë e mirë, por në fund fitores iu gëzuan suedezët

MOSKË, 3 KORRIK - Suedia ka mposhtur Zvicrën 1-0 duke kaluar në çerekfinalen e Kupës së Botës. Katër futbollistët shqiptarë janë paraqitur mirë edhe në këtë ndeshje, por janë suedezët që do të vazhdojnë të jenë pjesë e Kupës së Botës. Ishte një ndeshje e fortë mes dy skuadrave që nuk shquhen për kualitet teknik, por për shpirt gare dhe punë të madhe në prapavijë. Zvicra, me Shaqirin dhe Xhakën, do të kthehet në shtëpi. Ashtu siç pritej, ndeshja ishte e ekuilibruar në maksimum. Skuadrat luajnë me shumë kujdes, duke sulmuar me pak forca pa lënë hapësira mbrapa duke iu ruajtur kështu kundërsulmeve. Marcus Berg kishte një rast të mirë shënimi për të kaluar Suedinë në epërsi, por goditja e tij u ndal nga portieri Sommer. Po ashtu, Ekdal ka mundësinë më të mirë të ndeshjes, por ai nuk godet mirë. Pas pushimit situata nuk ndryshon, deri në momentin e golit. Ishte Emil Forsberg ai që kaloi skandinavët në avantazh në minutën e 66 me shumë fat, por loja e mirë e suedezëve ka merituar një gol. Më në fund Zvicra zgjohet dhe del përpara. Menjëherë fillon të jetë e rrezikshme me Embolo në të majtë. Dominimi i Zvicrës vazhdoi deri në fund të ndeshjes, por sulmet e tyre përfunduan pa sukses dhe në fund fitores iu gëzua Suedia.



Kualifikohen Roger Federer dhe Serena Williams

LONDËR, 3 KORRIK - Edicioni i 132-të i turneut "Grand Slam" të Wimbledonit, që feston 150-vjetorin e krijimit të tij, nisi me një surprizë të madhe. Sloan Stephens, finalistja e "Roland Garros", u eliminua që në raundin e parë. Ishte Donna Vekić ajo që shkaktoi këtë befasi në ditën e parë të Wimbledonit, teksa e mundi tenisten amerikane 2-0. Vekić ishte dominuese në lojë, duke i fituar të dy setet me rezultatin 6-1 dhe 6-3. Për në raundin tjetër u kualifikuan edhe motrat Williams. Serena Williams, që u tërhoq nga "Roland Garros", mundi në raundin e parë holandezen Rus me rezultatin 2-0, me sete 7-5 dhe 6-3. Ndërsa Venusi eliminoi pas tri seteve Johana Larsson. Venus Williams humbi setin e parë 6-7, por dominoi në dy të tjerët duke i mbyllur me rezultatin 6-2 dhe 6-1. Në kampin e meshkujve, Roger Federer dominoi në ndeshjen e raundit të parë me Dusan Lajović, të cilin e mundi 3-0. Zvicerani,



që ka ndërruar edhe sponsor duke kaluar nga Nike te Uniqlo, nuk e vuri në diskutim asnjëherë këtë fitore, duke i mbyllur setet me rezultatin 6-1, 6-3 dhe 6-4. Për në raundin e dytë të turneut të Wimbledonit u kualifikua edhe finalist i vitit të kaluar, Marin Čilić. Tenisti kroat eliminoi japonezin

Yoshihito Nishioka, duke e mundur me rezultatin 3-0. Čilićit iu desh vetëm një orë e 46 minuta lojë për të fituar këtë ndeshje, me setet 6-1, 6-4 dhe po 6-4. Surpriza e vetme në kampin e meshkujve për turneut e Wimbledonit ishte eliminimi i Čorićit, fituesi i turneut të "Halle"-s, që u mposht nga Medvedev.

SHKURT

Juve i ofron Ronaldos 30 milionë euro në vit

Sipas gazetës spanjolle "Marca", Juventus i ka ofruar Cristiano Ronaldos pagë 30 milionë euro në vit për t'u larguar nga Real Madridi. Juventus raportohe se i ka ofruar Ronaldos kontratë katërvjeçare dhe se tashmë ka kontaktuar me Realin për të arritur marrëveshje. Ronaldo ka një klauzolë një miliard euro në kontratë, por ajo mendohet se është ulur për klubet që s'janë "rivale direkt". Nuk dihet nëse Juventus hyn në këtë kategori. "Marca" raporton se Reali nuk ka qëllim ta mbajë Ronaldon e pakënaqur, që tashmë thuhet se ka marrëveshje verbale me "Zonjën e Vjetër".

Cousins përforcon kampionen e NBA-s

DeMarcus Cousins ka arritur një marrëveshje me kampionët në fuqi të NBA-së, Golden State Warriors, për një sezon dhe do të përfitojë 5.3 milionë dollarë. "Kjo është lëvizja ime e shahut", ka thënë Cousins, i cili, për të luajtur me Warriorsin, ka pranuar një ulje të konsiderueshme page, pasi sezonin e kaluar fitonte 18 milionë dollarë me New Orleans Pelicans. Me Cousins në skuadër, Golden State numërojnë në grupin e lojtarëve plot 6 "All Star": Stephen Curry, Klay Thompson, Kevin Durant, Draymond Green, DeMarcus Cousins dhe Andre Iguodala.

PSG-ja e vendosur për transferimin e Bonuccit

Kapiteni i Milanit, Leonardo Bonucci, nuk po kërkohet vetëm nga Manchester Unitedi, por edhe nga Paris Saint-Germain. "La Gazzetta dello Sport" raporton se kampionia e Francës, PSG-ja, është e vendosur për transferimin e Leonardo Bonuccit, i cili shihet si një lojtar që do të sjellë siguri të madhe në repartin e mbrojtjes. Transferimi i mbrojtësit italian nuk duket i vështirë, sidomos pas dënimit të Milanit me mospjesëmarrje në Ligën e Evropës.

"Mirror": Mahrezi, afër Leicesterit

Riyad Mahrez është gjithnjë e më afër largimit nga Leicester City. "Mirror" shkruan se mesfushori algerian së shpejti pritet ta kompletojë transferimin te kampioni i Premierligës, Manchester City. Mahrez ishte objektiv i "Citizens" edhe në edicionin e kaluar, pasi trajneri Pep Guardiola dëshiron ta sjellë Mahrezin në "Etihad Stadium".

Lowi nuk largohet nga Gjermania

Kur të gjithë prisnin shkarkimin e Joachim Lowit, "Sport Bild" ka publikuar një lajm ekskluziv, ku thuhet se tekniku do të vazhdojë të jetë pjesë e "panzerave", pavarësisht prej zhgënjimit në këtë Botëror. Ky vendim është marrë nga vetë Low, i cili do ta respektojë kontratën që i skadon në vitin 2022, ku do të marrë përsipër t'i rikthejë nderin Gjermanisë. Tifozët gjermanë nuk e kanë pritur mirë këtë lajm pasi, sipas tyre, Low duhet të largohet nga kombëtarja.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
 MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
 DEPARTAMENTI I FINANCEVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES /
 DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA
 DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, L. nr. 03/L-149, Rregulloren nr. 02/2010, për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Titulli i punës: Zyrtar për Burime Njerëzore

Kategoria funksionale /Koeficienti: 7

Numri i referencës: 34/2018

I përgjegjet: Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore

Vendi: Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë: Nën mbikëqyrjen e Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore i kryen detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Është përgjegjës për nxjerrjen e raporteve nga sistemi i menaxhimit të vijueshmërisë të nëpunësve civil
2. Në baza ditore, javore, mujore nxjerrë raportet e vijueshmërisë dhe pushimeve të nëpunësve civil;
3. Ndihmon organizimin e trajnimeve për stafin e institucionit;
4. Ndihmon në hartimin e doracakëve të trajnimit dhe pakove informative që përdorën në kurset e trajnimit;
5. Bashkëpunon me IKAP dhe agjencinë tjera relevante lidhur me organizimin e trajnimeve;
6. Evidenton në dosje të personelit të gjitha trajnimet e mbajtura;
7. Ndihmon udhëheqësit e njësive organizative lidhur me planifikimin e personelit;
8. Kryen edhe detyra tjera në pajtim me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat me arsye mund të kërkojnë kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

Shkollimi i kërkuar, përvoja, aftësitë dhe karakteristikat personale:

- Diploma universitare Shkencat Shoqërore: Juridik, Ekonomik, Shkencat Politike, Sociologji, së paku (dy) 2 vite përvojë pune profesionale;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme lidhur me shërbimin civil;
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Aftësi për përbushje të detyrave dhe punëve nën presion
- Shkathësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Procedurat e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur për të gjithë kandidatët

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi është i hapur tetë (15) ditë pas ditës së shpalljes.

Data e fundit e aplikimit është 18.07.2018

Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave: Aplikacioni merret dhe dorëzohet në zyrën 27 të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Sheshi "Nëna Tereza" nr. 44. Për informata shtesë kontaktoni në numrin 038211449 (apo në ueb-faqen <http://www.mkrs-ks.org/>). „Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike, qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Ligjin për Shërbimin Civil të Kosovës”. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
 MINISTARSTVO KULTURE, OMLADINE I SPORTA/ MINISTRY OF CULTURE YOUTH AND SPORTS
 DEPARTAMENTI I FINANCEVE DHE SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME / DEPARTMENT OF FINANCES AND GENERAL SERVICES / DEPARTMAN I FINANSIJA I GENERALNIH USLUGA
 DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE / DIVISION OF HUMAN RESOURCES / DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

Na osnovu Zakona o državnoj službi Republike Kosovo, br. 03/L-149, Pravilnika br. 02/2010 o procedurama zapošljavanja u državnoj službi Republike Kosovo, Ministarstvo kulture, omladine i sporta objavljuje:

KONKURS

Naziv radnog mesta: Službenik za ljudske resurse

Funkcionalna Kategorija: Koeficient: 7

Broj referencije: 34/2018

Nadzornik: Šef Divizije za ljudske resurse

Mesto: Priština

Dužnosti i odgovornosti: Pod nadzorom Šef Divizije za ljudske resurse ispunjuje sledeće dužnosti i odgovornosti:

Dužnosti i odgovornosti:

1. Odgovoran je za izdavanje izvještaja iz sistema upravljanja javnim službama
2. Dnevno, nedeljno, mesečno izdaje izvještaje o prisustvu i razrešenju državnih službenika;
3. Pomaže organizaciji obuka za osoblje ustanove;
4. Podržava razvoj priručnika za obuku i informativne pakete koji se koriste na kursevima obuke;
5. Sarađuje sa KIPA i drugim relevantnim agencijama u vezi sa organizovanjem obuka;
6. Identifikuje u kadrovskim dosijeima sve održane obuke;
7. Pomaže rukovodiocima organizacijskih jedinica u planiranju osoblja;
8. Obavlja i druge poslove u skladu sa važećim zakonima i propisima koji se mogu povremeno tražiti od strane nadzornog.

Zahtevano obrazovanje, iskustvo, sposobnosti i lične karakteristike:

- Diploma Univerziteta, društveni smerovi: Pravni, Ekonomski, Političke Nauke, Sociologija, (dve) 2 godine stručnog radnog iskustva;
- Saznanja o zakonima i uredbama u snazi vezanim sa civilnom službom;
- Veštine u planiranju, komunikaciji i vodstvu tima;
- Istraživanja, analitičke vještine evaluacije i formulisanje preporuka i profesionalnih saveta;
- Sposobnost obavljanja dužnosti i rada pod pritiskom
- Veštine kompjuterskog rada sa softverskim aplikacijama (Word, Excel, Power Point, Access);

Procedura konkurisanja:

- Konkurs je otvoren za sve kandidate

Datum isteka konkursa: Konkurs je otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja.

Zadnji datum za prijave je: 18.07.2018

Prijave poslate preko pošte, sa poštanskom markom, na zadnji dan objave, smatraće se važećim.

Dostava zahteva: Aplikacije se mogu skinute sa web stranice MKOS-a i predaju se u kacerariji br. 27 u Ministarstvu Kulture, Omladine i Sporta, Trg "Majka Tereza" br. 44. Za dodatne informacije kontaktirajte brojeve tel. 038 211 921 i 038 211 449, ili web-stranicu <http://www.mkrs-ks.org/>. "Civilna služba Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja prijave svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu. Nevećinske zajednice i njihovi članovi imaju pravo na pravičnu i proporcionalnu zastupljenost u organima državne uprave u javnoj, centralnoj i lokalnoj javnoj upravi, kako je navedeno u članu 11 stav 3 Zakona br. 03/L-149 o Zakonu o državnoj službi Kosova". Zahtevi poslati nakon poslednjeg datuma i nepotpuni zahtevi neće biti prihvaćeni. Zbog velikog broja primljenih aplikacija, kontaktiraće se samo kandidati koji su izabrani na izbornoj listi.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr.03/ L -149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë shpall:*

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë*

Departamenti: Zyra e Sekretarit të përgjithshëm
Paga bruto: 483.34 €

Titulli i vendit të punës: Përkthyes/e nga gjuha shqipe në gjuhën angleze dhe anasjelltas (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë **Datë:** 03.07.2018

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Përkthyesi do të ofrojë shërbime përkthimi për nevoja të Ministrit dhe Kabinetit të Ministrit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe do të jetë përgjegjës që të bëjë:

- Përkthim konsektiv nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas gjatë takimeve të Ministrit dhe anëtarëve tjerë të kabinetit me partnerët zhvillimor të MASHT-it dhe me palët tjera të interesit nga jashtë;
- Përkthim simultan nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas gjatë konferencave dhe punëtorive të cilat i organizon kabineti i Ministrit dhe/ose departamentet e ndryshme në kuadër të MASHT-it me partnerët zhvillimor dhe palët tjera të interesit nga jashtë;
- Përkthim me shkrim, nga gjuha shqipe në atë angleze dhe anasjelltas, materiale të ndryshme (dokumente, shkresa, korrespondencë) që prodhohen nga kabineti i Ministrit;

Kualifikimet

- Dëshmi mbi kryerjen e fakultetit të gjuhës angleze;
- Më së paku 5 vjet përvojë pune në fushën e arsimit dhe në përkthimin e dokumenteve nga kjo fushë;
- Të jetë njohës i mirë gjendjes në arsim dhe projekteve të partnerëve zhvillimor në mbështetje të sektorëve të ndryshëm të arsimit në Kosovë në përgjithësi, dhe MASHT-it në veçanti;
- Të jetë përkthyes i licencuar.
- Shkathësi komunikimi me shkrim dhe me gojë në gjuhët zyrtare;
- Shkathësi të shkëlqyeshme përkthimi me shkrim dhe me gojë;
- Shkathësi për të përkthyer dokumente, në mënyre profesionale, të qartë dhe të saktë;
- Njohuri të mira pune me programet kompjuterike.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 6 ditë kalendarike nga dita e publikimit në uebfaqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit **9.07.2018.**

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në web faqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rr. "Agim Ramadani" nr. 1 në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosova Zakona br. 03/ L -149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije objavljuje:*

Konkursa za "Sporazum o posebnim uslugama "

Institucija *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije*

Departament: Kancelarija generalnog sekretara
Plata bruto: 483.34 €

Naziv radnog mesta: Prevodilac sa engleskog na albanski jezik i obrnuto (1 radno mesto)

Vreme trajanja ugovora: 6 meseci

Radno mesto: Priština **Datum:** 03.07.2018

Radni zadaci i odgovornost

1. Prevodilac pruža usluge prevođenja za potrebe Ministra i Kabineta ministra obrazovanja, nauke i tehnologije (MONT) i odgovoran je za:
 - Konsektivni prevod sa albanskog jezika na engleski i obrnuto na sastancima sa Ministrom i kabinetom ministra sa razvojnim partnerima MONT-a i druge zainteresovane strane izvan;
 - Simultani prevod sa albanskog jezika na engleski i obrnuto na konferencijama i radionice koje organizuje kabinet Ministra i/ili drugi departamenti u okviru MONT-a sa razvojnim partnerima i druge zainteresovane strane izvani;
 - Pisani prevod, sa albanskog jezika na engleski i obrnuto, različite materijale (dokumenta, dopise, prepiske) koje priprema kabinet ministra;

Kvalifikacije

- Njohuri të mira pune me programet kompjuterike
- Dokaz o završenom fakultetu engleskog jezika;
- Najmanje 5 godina radnog staža u oblasti obrazovanja i prevođenju dokumenata iz ove oblasti;
- Da poznaje dobro stanje u obrazovanju i razvojnim partnerima uz globalnu podršku različitim sektorima u obrazovanju na Kosovu, a posebno MONT-a
- Da je licenciran prevodilac.
- Da poseduje veštine za pisanu i usmenu komunikaciju na službenim jezicima;
- Odlične veštine prevođenja pismeno i usmeno;
- Veštine za prevođenje dokumenata, profesionalno, jasno i tačno;
- Dobro poznavanje rad sa kompjuterskim programima

Uslovi učesće na konkurs:

Pravo na aplikaciju imaju svi punoletni građani Republike Kosova koji imaju sposobnost delovanja, koji imaju potrebnu školsku spremu i profesionalnu sposobnost za izvršavanje obaveza i ona lica koja imaju fizičku sposobnost koja se zahteva za relevantan položaj.

Datum završetka konkursa: Konkurs je otvoren 6 kalendarska dana od dana objavljivanja na web stranici MONT-a i dnevnoj štampi. Dan završetka konkursa je **9.07.2018.**

Kandidati aplikacija (obrazac za konkurisanje) mogu preuzeti na web stranici MONT-a <http://masht.rks-gov.net/>, ili u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, Adresa: Ul. "Agim Ramadani" br. 1, kancelariji arhive u kojoj će kasnije takođe popunjene aplikacije predati.

Uz aplikaciju mora biti priložena: Kopija lične karte, kopija dokumentacije o o kvalifikovanju, kao i ostala dokumentacije potrebna koja se zahtevaju konkursom.

Zahtevi dostavljeni nakon isteka konkursa neće biti primljeni. Zbog velikog broja primljenih zahteva, kontaktiraćemo samo kandidati koji budu izabrani na užoj listi.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gasensas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Afati i paraqitjes prej 03.03.2018
deri më 10.03.2018**

Ju mirëpret:

Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333